

MPLAKJA E POPULLSISË

SITUATA E TË MOSHUARVE NË SHQIPËRI



MPLAKJA E POPULLSISË

SITUATA E TË MOSHUARVE NË SHQIPËRI



MPLAKJA E POPULLSISË: SITUATA E TË MOSHUARVE NË SHQIPËRI

Nëntor 2015

Drejtor Botimi:

Dr. Gjergji Filipi

Autorët:

Bart de Bruijn

Dr. Gjergji Filipi

Majlinda Nesturi, INSTAT

Emira Galanxhi, INSTAT

Ndihmuan:

Olgeta Dhono

Alma Kondi

Pranvera Elezi

Përkthimi në shqip:

Lisena Gjebrea

Copyright © INSTAT 2015

Mendimet e shprehura në këtë studim janë përgjegjësi e INSTAT. Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në çdo formë pa autorizim paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

Shënim:

Ky publikim është realizuar me ndihmën e zyrës së UNFPA në Shqipëri dhe Qendrës Kombëtare për Studime Sociale (QKSS), financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

ISBN: 978-9928-188-35-9



INSTITUTI I STATISTIKAVE

Bul. "Zhan D'Ark", Nr. 3, Tiranë, Shqipëri

Tel: +(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356

Fax: +(355) 4 2228300

E-mail: info@instat.gov.al

Web: www.instat.gov.al

Grafika: 

Shtypi: 

PARATHËNIE DHE FALENDERIME

INSTAT në bashkëpunim të ngushtë me UNFPA ka zhvilluar një proces analize të thelluar të të dhënave të Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2011, duke i krahasuar ato edhe me tregues të tjerë administrativë apo vrojtime të ndryshme. Në vijimësi të këtij bashkëpunimi është kryer një studim i thelluar mbi të moshuarit dhe se si përballet ky grup me ndryshimet dhe sfidat e kohës.

“Mplakja e Popullsisë: Situata e të moshuarve në Shqipëri”, do të shërbejë më së miri për të pasur një vlerësim më të qartë të jetesës së të moshuarve të grupmoshës mbi 65 vjeç. Shqipëria po fillon të përjetojë efektet e mplakjes së popullsisë. Gjatë dy dekadave të fundit vendi ka patur një transformim të thellë demografik të shoqëruar me një rritje të numrit të personave mbi 65 vjeç dhe rënie të numrit të fëmijëve dhe të të rinjve. Politikë-bërësit duhet të jenë të përgatitur për këtë proces, i cili do të ketë ndikimin e tij në dekadat që vijnë në të gjitha aspektet e jetës: ekonomike, sociale dhe politike.

Kjo analizë i bashkohet serisë së analizave të mëparshme që INSTAT ka kryer në bashkëpunim me donatorë të tjerë. INSTAT gjen rastin të shprehë mirënjohje dhe falenderime për kontributin e çmuar të Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA), Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Qendrës Kombëtare për Studime Sociale (QKSS), INSTAT dhe ekspertëve të tjerë vendas dhe të huaj për këtë botim.

Dr. Gjergji Filipi

Drejtore i Përgjithshëm i INSTAT



TABELA E PËRMBAJTJES

Kapitulli 1: Hyrje	9
Kapitulli 2: Demografia	11
2.1 Hyrje	11
2.2 Shkalla dhe shpejtësia e moshimit të popullsisë	11
2.3 Ekuilibri i ndryshueshëm mes grupmoshave	14
2.3.1 Raporti i varësisë	14
2.3.2 Mosha medianë	16
2.3.3 Popullsia e vjetër më e moshuar	16
2.3.4 Raporti gjinor	17
2.4 Përcaktuesit demografikë të moshimit të popullsisë	18
2.4.1 Lindshmëria dhe vdekshmëria	18
2.4.2 Migracioni	20
2.5 Dallimet rajonale	21
Kapitulli 3: Njësia ekonomike familjare dhe kushtet e jetesës	23
3.1 Hyrje	23
3.2 Madhësia dhe struktura e njësisë ekonomike familjare	23
3.3 Gjendja civile	26
3.4 Kushtet e jetesës së të moshuarve	27
3.4.1 Të moshuarit dhe varfëria	27
3.4.2 Kushtet e strehimit	28
3.4.3 Shfrytëzimi i banesës	29
3.4.4 Uji dhe higjiena	30
3.4.5 Ngrohja e banesës	31
Kapitulli 4: Shëndeti	33
4.1 Hyrje	33
4.2 Shëndeti i vetë-vlerësuar	33
4.3 Duhani dhe përdorimi i alkoolit	34
4.4 Aftësia e kufizuar	35
Kapitulli 5: Të moshuarit në punë	39
5.1 Hyrje	39
5.2 Sistemi i pensioneve në Shqipëri	39
5.3 Të punuarit dhe të mos punuarit	39
5.4 Karakteristikat e të moshuarve që punojnë	40

Kapitulli 6: Moshimi aktiv dhe vulnerabiliteti	41
6.1 Hyrje	41
6.2 Moshimi aktiv	41
6.3 Indeksi i vulnerabilitetit të të moshuarve	44
 Kapitulli 7: Përmbledhje	 47
7.1 Hyrje	47
7.2 Të moshuarit, brezi i së ardhmes	47
7.3 Mosha dhe shëndeti i mirë: shokë të vështirë	48
7.4 Të jetuarit vetë ose së bashku?	49
7.5 Dhe si janë kushtet e strehimit?	49
7.6 Mirëqenia materiale	49
 Anekset	 51
Aneksi I Koncepte dhe përkufizime	51
Aneksi II Përbërja e Indeksit Global të Mbikëqyrjes së Moshës	53
 Referencat	 54

LISTA E FIGURAVE

Figura 2.1: Struktura e popullsisë, 1979-2011 dhe 2015-2060 (në mijë)	12
Figura 2.2: Popullsia 65 vjeç e lart, 1979-2060 (në mijë)	13
Figura 2.3: Rritja vjetore e popullsisë dhe rritja vjetore e popullsisë e moshës 65 vjeç e lart, 2001-2060 (në përqindje)	13
Figura 2.4: Popullsia sipas tre grupmoshave kryesore, 1979-2060 (në përqindje)	14
Figura 2.5: Raporti total i varësisë, raporti i varësisë të rinjve dhe të moshuarve, 1979-2060 (në përqindje)	15
Figura 2.6: Moshë mediane e popullsisë, 1979-2060	16
Figura 2.7: Popullsia 65 vjeç e lart sipas grupmoshës, 1979-2060 (në mijë)	16
Figura 2.8: Raporti gjinor i popullsisë 65 vjeç e lart, 1979-2060 (në përqindje)	17
Figura 2.9: Indeksi Sintetik i Fekonditetit (ISF) dhe jetëgjatësia në lindje, 2004-2014	18
Figura 2.10: Jetëgjatësia në lindje e meshkujve dhe femrave dhe hendeke gjinor, 2004-2014 (në vite)	19
Figura 2.11: Jetëgjatësia në moshën 65 dhe 80 në 2005-2009 dhe 2010-2014 (në vite)	19
Figura 2.12: Migracioni neto i përlogarit sipas moshës për periudhën 2001-2011	20
Figura 2.13: Përqindja e popullsisë 65 vjeç e lart, sipas vitit të censusit dhe sipas qarkut	21
Figura 2.14: Raportet e varësisë sipas qarqeve, 2011	22
Figura 2.15: Raporti i varësisë së moshuarve i projektuar, sipas qarkut 2031	22
Figura 3.1: Madhësia e popullsisë, numri i njësive ekonomike familjare dhe madhësia mesatare e njësive ekonomike familjare, sipas vitit të censusit	24
Figura 3.2: Popullsia e moshuarve 65 vjeç e lart sipas vitit të censusit dhe sipas madhësisë së njësive ekonomike familjare	24
Figura 3.3: Popullsia e moshuarve, meshkuj dhe femra, 65 vjeç e lart, sipas lidhjes me kryefamiljarin dhe sipas moshës (në përqindje)	26
Figura 3.4: Popullsia e moshuarve, meshkuj dhe femra, të moshës 65 vjeç e lart, sipas gjendjes civile dhe sipas moshës (në përqindje)	27
Figura 3.5: Popullsia e moshuarve 65 vjeç e lart, sipas censusit dhe sipas zotërimit të pajisjeve afatgjata (në përqindje)	28
Figura 3.6: Popullsia e moshuarve 65 vjeç e lart, sipas llojit të njësive së strehimit (në përqindje)	29
Figura 3.7: Përqindja e popullsisë të moshuar 65 vjeç e lart që jeton në banesë të mbipopulluar, sipas vitit të censusit dhe qarkut	30
Figura 3.8: Shpërndarja e (a) furnizimit me ujë dhe (b) tualetit për popullsinë e moshuarve 65 vjeç e lart, sipas vitit të censusit dhe llojit të tualetit (në përqindje)	31
Figura 3.9: Popullsia e moshuar 65 vjeç e lart sipas llojit të ngrohjes në banesë (në përqindje)	32
Figura 4.1: Të moshuarit 65 vjeç e lart, sipas vetë vlerësimit të gjendjes shëndetësore (në përqindje)	33
Figura 4.2: Përqindja e moshuarve 65 vjeç e lart që pi duhan, sipas vitit të anketës	34
Figura 4.3: Të moshuarit 65 vjeç e lart sipas konsumit të alkoolit (në përqindje)	35
Figura 4.4: Prevalenca e aftësisë së kufizuar sipas gjinisë dhe sipas moshës (në përqindje)	36
Figura 4.5: Prevalenca e aftësisë së kufizuar për lloje të ndryshme aftësish të kufizuara mes të moshuarve, sipas gjinisë (në përqindje)	36
Figura 4.6: Popullsia 45 vjeç e lart sipas statusit të aftësisë së kufizuar dhe nivelit arsimor (në përqindje)	37
Figura 5.1: Popullsia e moshuarve 65 vjeç e lart që punon, sipas gjinisë dhe sektorit të punës (në përqindje)	40
Figura 6.1: Indeksi global i mbikëqyrjes së moshës Shqipëria 2014 (renditja)	42
Figura 6.2: Treguesit global të mbikëqyrjes së moshës Shqipëria 2014	43
Figura 6.3: Indeksi i përgjithshëm global i mbikëqyrjes së moshës, sipas vendit të përzgjedhur (2014)	43
Figura 6.4: Treguesit globalë të mbikëqyrjes së moshës sipas vendit të përzgjedhur dhe sipas fushës (2014)	44
Figura 6.5: Indeksi i vulnerabilitetit të moshuarve 65 vjeç e lart, sipas bashkisë	45

SHKURTIME

IMA	Indeksi i Moshimit Aktiv
GNI	Të Ardhura Kombëtare Bruto
AFS	Anketa e Forcës së Punës
AMNJ	Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës
OZHM	Objektiva të Zhvillimit të Mijëvjeçarit
CPB	Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011
ISF	Indeksi Sintetik i Fekonditetit
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Veprimtaritë e Popullsisë
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetit

1

Hyrje

Si një nga vendet e fundit në Europë, Shqipëria po fillon të përjetojë efektet e moshimit të popullsisë - procesi sipas të cilit të moshuarit zënë një përqindje proporcionalisht më të madhe të të gjithë popullsisë. Në dy dekadat e fundit, ka ndodhur një transformim demografik i veçantë, ndërsa rritja e përqindjes së personave të moshuar - 65 vjeç e lart - shoqërohet me ulje të përqindjes së fëmijëve dhe të të rinjve. Politikëbërësit duhet të përgatiten që forca e plotë e këtij procesi transformimi të ndihet në dy dekadat e ardhshme dhe të prekë të gjitha sferat e jetës: ekonomike, sociale dhe politike.

Asambleja e Dytë Botërore për Moshimin në prill 2002¹ trajtoi sfidat që paraqet ky proces i moshimit të popullsisë pothuajse për të gjitha vendet e botës. Këto sfida përfshijnë nevojën për të transformuar sistemin ekzistues të pensioneve dhe për të plotësuar kërkesat gjithnjë e në rritje për shërbime shëndetësore dhe shpenzime mjekësore, ndërsa të moshuarit janë më të rrezikuar nga sëmundjet kronike. Në zonën ekonomike, moshimi i popullsisë ka ndikim në zhvillimin ekonomik, kursime, investime, konsum, tregje pune, tatime dhe transferime ndërmjet brezave. Në sferën sociale, ndikon në përbërjen familjare dhe jetesën dhe kërkesat për strehim. Në fushën politike, moshimi i popullsisë mund t'i japë trajtë modeleve të votimit dhe përfaqësimit politik (Organizata e Kombeve të Bashkuara, 2009).

Plani i Veprimit që u miratua në Asambleenë Botërore 2002 u fokusua në tre fusha prioritare, që orientojnë politikëbërësit të trajtojnë moshimin e popullsisë dhe mirëqenien e të moshuarve: (a) personat e moshuar dhe zhvillimi; (b) përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies në moshën e vjetër; dhe (c) sigurimi i mjediseve mbështetëse dhe mundësuese (Organizata e Kombeve të Bashkuara, 2002). Plani synon të garantojë që të moshuarit të kuptojnë plotësisht të drejtat e njeriut, të kenë moshimin e sigurt dhe larg varfërisë, të marrin pjesë plotësisht në jetën ekonomike, politike dhe sociale dhe të kenë mundësi për zhvillim në periudhat e tjera të jetës. Gjithashtu fokusohet në eliminimin e dhunës dhe diskriminimit kundër personave më të moshuar, barazinë gjinore, rëndësinë e familjeve, kujdesin shëndetësor dhe mbrojtjen sociale për personat më të moshuar.

Ky raport prodhohet nga INSTAT në emër të UNFPA si input në diskutime për moshimin e popullsisë në Shqipëri, pasojat e tij dhe nevojat e politikave që lidhen me të. Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011 përbën shtyllën e analizës. Kur është e mundur, rezultatet e censurit të vitit 2011 krahasohen me rezultatet e censuseve të mëparshme për të përcaktuar tendencat e treguesve përkatës. Të dhënat administrative si edhe të dhëna nga anketime të ndryshme plotësuese dhe që japin më shumë detaje për informacionin e censurit. Për tema të ndryshme, informacioni i saktë i përditësuar është i pakët. Kjo ndihet veçanërisht në fushën e shëndetit dhe pjesëmarrjes në shoqëri.

Kapitulli 2 fokusohet në aspektet demografike të moshimit të popullsisë, shkaqet, shkallën dhe shpejtësinë e procesit, ndikimin e tij në ekuilibrin ndërmjet grupmoshës dhe gjinisë, projeksionet e procesit të moshimit si edhe dallimet rajonale brenda Shqipërisë. Kapitulli 3 trajton jetesën e të moshuarve sa i përket përbërjes së njësisë ekonomike familjare dhe gjendjen civile si edhe sa i përket kushteve materiale, që përfshijnë varfërinë dhe kushtet e strehimit dhe pajisjet afatgjata. Kapitulli 4 dhe 5 analizon situatën shëndetësore dhe të punësimit të të moshuarve, ndërsa kapitulli 5 jep masa të përgjithshme të shkallës së vulnerabilitetit të të moshuarve në Shqipëri, ose nga ana tjetër mundësinë e tyre për t'u moshuar në mënyrë aktive dhe pjesëmarrëse. Kapitulli 7 bën një përmbledhje dhe paraqet konkluzionet kryesore.

1 http://www.un.org/en/events/pastevents/ageing_assembly2.shtml



2 DEMOGRAFIA

2.1 HYRJE

Struktura e popullsisë mund të ndryshojë ndjeshëm me kalimin e viteve si rezultat i ndërveprimit të proceseve demografike- si për shembull lindshmëria, vdekshmëria ose migracioni- dhe faktorëve të tjerë indirekt, si zgjedhjet e stilit të jetës ose ofrimi dhe efica e shërbimeve të kujdesit shëndetësor.



Ky kapitull jep një paraqitje të përgjithshme të moshimit të popullsisë në Shqipëri. Ai jep një paraqitje të popullsisë së moshuar 65 vjeç e lart, duke u fokusuar në shkallën dhe shpejtësinë e moshimit të popullsisë, si edhe përcaktuesit demografikë të moshimit. Këta përcaktues demografikë janë faktorët kryesorë në themel të ndryshimit të popullsisë, si rënia e lindshmërisë dhe vdekshmërisë, emigracioni më bazë të gjerë. Sidomos në fazat e hershme të tranzicionit demografik, rënia e lindshmërisë është përcaktuesi parësor i kohës dhe shtrirjes së moshimit të popullsisë. Megjithatë, në faza të mëvonshme të tranzicionit, rënia e vdekshmërisë, sidomos e moshave më të vjetra, kontribuon më shumë në rritjen e numrit të personave të moshuar, duke përsheptuar kështu moshimin e popullsisë. Një pasojë e rëndësishme e rënies së lindshmërisë është rënia progresive e të afërmeve mbi të cilin mund të mbështeten brezat e ardhshëm të personave më të moshuar. Njëkohësisht, mundësi më të mira për mbijetesë të moshave më të vjetra duket se nxisin përpjekjet për të përmirësuar statusin shëndetësor të popullsisë më të moshuar dhe çon në reformimin e sistemeve të pensionit dhe shëndetit.

Më tej, ky kapitull konsideron ekuilibrin e ndryshueshëm ndërmjet grupmoshave dhe analizon ndryshimet në madhësinë relative të grupmoshave më të vjetra dhe më të reja të popullsisë nga perspektiva të ndryshme. Treguesit e shqyrtuar përfshijnë moshën medianë dhe lloje të ndryshme të raporteve të varësisë (gjithsej, i të rinjve dhe i të moshuarve). Në këtë drejtim, shpjegohen gjithashtu dallimet rajonale. Analiza në këtë kapitull, përfshin pritshmëritë e ardhshme bazuar në projeksionet e popullsisë për pesë dekadat e ardhshme.

2.2 SHKALLA DHE SHPEJTËSIA E MOSHIMIT TË POPULLSISË

Proceset përbërëse të emigracionit të vazhdueshëm në shkallë të gjerë dhe lindshmëria dhe vdekshmëria në rënie kanë pasur një ndikim shumë të madh në strukturën e popullsisë së Shqipërisë. Vëzhgimi i dukshëm i shpërndarjes sipas moshës dhe gjinisë (Figura 2.1) tregon qartë tranzicionin nga një piramidë klasike e popullsisë në vitin 1979 në një piramidë konstruktive në vitin 2011. Ndërsa deri në vitin 1989, shpërndarja sipas moshës është karakterizuar nga grupmosha që janë zvogëluar në mënyrë të vazhdueshme me moshën, një ulje e dukshme është vënë re në vitin 2011 për popullsisë e të rinjve dhe të të rriturve të moshës së mesme për shkak të emigracionit me shkallë të gjerë që ka prekur këto grupmosha të popullsisë. Gjithashtu, një reduktim edhe më shumë i dukshëm në numër është i qartë për grupmoshat e reja - brezi 5-vjeçar me i ri, është më i vogli në popullsinë nën 55 vjeç - për shkak të efektit të kombinuar të rënies së lindshmërisë nga një ISF mbi 3 përpara 1990 (Gjonca, Aassve dhe Mencarini 2008) në më pak se 1.7 në vitin 2011 dhe emigracionit përzgjedhës të moshës së popullsisë në moshat e riprodhimit. Nga ana tjetër, brezat e të moshuarve janë rritur dukshëm.


Figura 2.1: Struktura e popullsisë, 1979-2011 dhe 2015-2060 (në mijë)



Burimi: Censuri i Popullsisë dhe Banesave 1979 dhe 2011 dhe projeksionet e popullsisë 2011-2060

Në vitin 1979, në Shqipëri ka pasur 76.5 mijë persona 65 vjeç e lart. Në vitin 2011, numri i personave 65 vjeç e lart është rritur më shumë se 4 herë në 318 mijë (Figura 2.2). Rritje të mëtejshme të numrit të të moshuarve janë projektuar në 5 dekadat e ardhshme, duke arritur 667 mijë në vitin 2060.

Figura 2.2: Popullsia 65 vjeç e lart, 1979-2060 (në mijë)




Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 1979 - 2011 dhe projektionet e popullsisë 2011-2060

Popullsia më e vjetër po rritet më shpejt sesa popullsia gjithsej

Ndërsa rritja vjetore e popullsisë është negative gjatë gjithë periudhës nga 2001 në projektionin e vitit 2060, ndryshe ndodh me rritjen vjetore të popullsisë të moshës 65 vjeç e lart (Figura 2.3). Në vitet e trajtuara nga censuset e popullsisë dhe në periudhën 2012 deri në 2030, dallimi ndërmjet normave të rritjes mbetet e lartë duke qenë se brezi i bumit të fëmijëve arrin moshën 65 vjeç. Për periudhën 2031-2050, projektionet tregojnë që norma vjetore e rritjes së popullsisë së të moshuarve do të ulet në mënyrë të qëndrueshme dhe madje do të arrijë vlerë negative në vitin 2039, kur brezat që janë zvogëluar nga emigracioni me shkallë të gjerë të arrijnë moshën e vjetër. Përtej vitit 2050, norma e rritjes së popullsisë së moshës 65 vjeç e lart pritet që të rritet përsëri në një rritje vjetore mesatare me 0.5 përqind në periudhën 2051-2060, ndërsa norma e rritjes së gjithë popullsisë do të mbetet negative gjatë këtyre viteve (-0.7 përqind).

Figura 2.3: Rritja vjetore e popullsisë dhe rritja vjetore e popullsisë e moshës 65 vjeç e lart, 2001-2060 (në përqindje)



Burimi: Vlerësimet e popullsisë 2001 - 2014 dhe projektionet e popullsisë 2011-2060


2.3 EKUILIBRI I NDRYSHUESHËM MES GRUPMOSHAVE

Figura 2.4 specifikon më tej ndryshimet në strukturën e popullsisë së Shqipërisë. Numri i personave në grupmoshën 15-64 vjeç ka mbetur mjaft i qëndrueshëm gjatë periudhës ndërmjet dy censuseve të fundit, duke rënë nga 1.96 milion në vitin 1989 në 1.90 në vitin 2011. Numri i fëmijëve nën 15 vjeç, megjithatë ka rënë ndjeshëm nga 1.05 milion në vitin 1989 në vetëm 579 mijë në vitin 2011. Nga ana tjetër, në një popullsi përgjithësisht në rënie, vërehet një rritje e mprehtë e numrit të të moshuarve 65 vjeç e lart nga 169 në 318 mijë në të njëjtën periudhë. Këto ndryshime tregojnë një transformim të plotë të shoqërisë në një periudhë kohore prej vetëm 22 vjet. Nga ana e tyre, këto zhvendosje përfshijnë implikime të rëndësishme në lidhje me çështje të zhvillimit si numri i shkollave dhe mësuesve që nevojiten, kërkesat për pensione, kujdesi për moshën e vjetër dhe shërbimet shëndetësore- të përdorura ndjeshëm nga të moshuarit- dhe numri i personave që pritet të hyjnë në tregun e punës dhe arsimin e lartë në të ardhmen e afërt.

Në terma relative, rritja e numrit të të moshuarve është edhe më e lartë. Pjesa e popullsisë 65 vjeç e lart është rritur nga 5 në 11 përqind ndërmjet viteve 1989 dhe 2011. Nga ana tjetër, përqindja e personave nën 15 vjeç në të gjithë popullsinë ka rënë në më pak se 21 përqind, nga 33 përqind në vitin 1989 dhe madje 37 përqind në vitin 1979. Zhvendosjet në këto përqindje relative të popullsisë ilustrojnë proceset përbërëse të një popullsie të moshuar: nga njëra anë “moshimi nga poshtë” (një bazë piramide më e ngushtë) nga gjithnjë e më pak lindje për shkak të uljes së lindshmërisë dhe emigracionit të grave në moshë riprodhimi, dhe nga ana tjetër “moshimi në majë” (zgjerimi i majës së piramidës) nga një popullsi e moshuar gjithnjë e më e madhe, si efekt i kombinuar i lindshmërisë së lartë në të shkuarën dhe jetëgjatësisë në rritje (Eurostat 2012).

Në të ardhmen, ndryshimi në shpërndarjen e moshës pritet që të jetë shumë i ndjeshëm gjithashtu. Përqindja e më të vjetërve do të rritet nga 11 përqind në vitin 2011 në 29 përqind në vitin 2060, ndërsa përqindja e fëmijëve është projektuar të përgjysmohet, duke arritur 12 përqind në vitin 2060. Gjatë kësaj periudhe, grupmosha 15-64 vjeç do të rritet deri në vitin 2020 dhe më pas do të ulet ndjeshëm në 59 përqind në vitin 2060.

Figura 2.4: Popullsia sipas tre grupmoshave kryesore, 1979-2060 (në përqindje)



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 1979 - 2011 dhe projeksionet e popullsisë 2011-2060

2.3.1 Raporti i varësisë

Raporti gjithsej i varësisë është një masë e përdorur zakonisht për nevojat e mundshme të mbështetjes sociale. Ai llogaritet si raporti i numrit të fëmijëve (persona nën moshën 15 vjeç) dhe personave të moshuar (persona 65 vjeç e lart) me numrin e personave në moshë pune (pra ata të moshës 15 deri në 64) të shprehur në përqindje. Ky interpretim i raportit bazohet në nocionin që të gjithë personat nën 15 vjeç dhe ata 65 vjeç e lart në një farë kuptimi mund të varen


nga popullsia në moshë pune. Ata në moshë pune mendohet se i ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë ose jo atyre që janë në moshë varësie (Kinsella dhe Gist, 1995). Megjithatë, pranohet që raporti i varësisë më së miri ofron vetëm një përafrim të barrës aktuale të varësisë në një shoqëri. Jo të gjithë fëmijët dhe personat më të moshuar kërkojnë mbështetje, as të gjithë personat në moshë pune japin mbështetje të drejtpërdrejtë ose jo për fëmijët dhe personat më të vjetër (Tauber 1992). Në fakt, të dhënat tregojnë që personat më të moshuar në shumë shoqëri shpesh i ofrojnë mbështetje fëmijëve të tyre më të rritur (Morgan, Schuster dhe Butler 1991, Saad 2001). Kështu, edhe pse është tregues i dobishëm i tendencave për nevojat e mundshme të mbështetjes, raporti i varësisë dhe sidomos, raporti i varësisë së të moshuarve, duhet të interpretohet me kujdes.

Figura 2.4 tregon që përqindja e popullsisë në grupmoshën 15-64 vjeç është rritur në mënyrë të qëndrueshme nga rreth 58 përqind në vitin 1979 në 68 përqind në vitin 2011. Kjo tregon që raporti i varësisë rrjedhimisht është ulur. Ndërsa në vitin 1979, ka pasur 73 persona në moshë më pak produktive të të rinjve dhe të të moshuarve në 100 banorë në moshë më shumë produktive, në vitin 2011 kjo shifër ka qenë vetëm 47. Figura 2.5 tregon një rënie të ndjeshme në barrën e personave në varësi brenda njësive ekonomike familjare dhe ekonomisë në përgjithësi. Me raportin e ulët të varësisë me 47 përqind, Shqipëria ndodhet në mes të dritares së mundësive ekonomike që përputhet përafërsisht me periudhën në fillim të viteve 2020 dhe censuset e ardhshme në vitin 2021. Ky episod i "dividentit demografik" rezulton nga një popullsi e madhe që mund të jetë ekonomisht produktive, krahasuar me numrin e vogël të të rinjve dhe të të vjetërve (p.sh Bloom, Canning dhe Sevilla 2003). Nga vitin 2021 dhe më tej, dritarja do të fillojë të mbyllet përsëri për shkak të rritjes së vazhdueshme të të moshuarve dhe shifrave të stabilizuara të fëmijëve (shihni INSTAT 2014b). Nëse Shqipëria përfiton apo jo nga ky divident demografik, kjo varet nga masa në të cilën forca e punës është e arsimuar, e kualifikuar dhe e shëndoshë mjaftueshëm dhe nëse politika të duhura ekonomike dhe sociale zbatohen për të punësuar këta persona në vende pune produktive.

Raporti gjithsej i varësisë mund të ndahet në raportin e varësisë të të rinjve dhe të të moshuarve, i cili përfaqëson përkatësisht raportin e popullsisë 0-14 vjeç dhe 65 vjeç dhe lart me popullsinë e grupmoshës 15-64 vjeç. Kjo ndarje tregon përsëri ndikimin e një popullsie të moshuar, ndërsa raporti në rënie i varësisë të të rinjve, që ulet nga 64 përqind në vitin 1979 në 30 përqind në vitin 2011, kompensohet gradualisht nga një raport në rritje varësie të të moshuarve, nga 9 në rreth 17 përqind në të njëjtën periudhë.

Nëse shtrijmë analizën në të ardhmen, projeksionet e popullsisë tregojnë që raporti i varësisë së të rinjve do të ulet më tej, ndërsa raporti i varësisë të të moshuarve do të rritet. Pritet që raporti i varësisë të të moshuarve pothuajse të trefishohet në vitin 2060, krahasuar me 2011 (49.5%).

Figura 2.5: Raporti gjithsej i varësisë, raporti i varësisë të të rinjve dhe të të moshuarve, 1979-2060 (në përqindje) ^a




Burimi: Censuset e popullsisë dhe banesave dhe projeksionet e popullsisë 2011-2060

a Raporti gjithsej i varësisë është raporti i popullsisë të moshës 0-14 vjeç dhe 65 vjeç e lart me popullsinë e grupmoshës 15-64 vjeç. Raporti i varësisë së të rinjve është raporti i popullsisë të moshës 0-14 vjeç me popullsinë e grupmoshës 15-64. Raporti i varësisë së të moshuarve është raporti i popullsisë të moshës 65 vjeç e lart me popullsinë e grupmoshës 15-64. Të gjitha raportet shprehen si përqindje.

2.3.2 Moshë mediane

Moshë mediane është moshë që ndan popullsinë në dy pjesë të barabarta, një me moshat nën moshën mediane dhe tjetra me moshat mbi moshën mediane. Ndërmjet 1979 dhe 2011, moshë mediane e popullsisë është rritur me 13 vjet, nga 20 vjet në 33 vjet (Figura 2.6). Nga viti 2011 deri në 2060, moshë mediane pritet të rritet më shumë me një shtesë prej 17 vjet. Pra, në vitin 2060, gjysma e popullsisë shqiptare projektohet se do të jetë më e moshuar se 50 vjeç.

Figura 2.6: Moshë mediane e popullsisë, 1979-2060




Burimi: Censuset e popullsisë dhe banesave dhe projeksionet e popullsisë 2011-2060

2.3.3 Popullsia e vjetër më e moshuar

Një aspekt i rëndësishëm i procesit të moshimit është moshimi demografik progresiv i vetë popullsisë më të vjetër. Në vitin 1979, përqindja e popullsisë 80 vjeç e lart përbën 17.8 përqind të popullsisë të moshuarve 65 vjeç e lart dhe vetëm 0.9 përqind të të gjithë popullsisë. Të vjetrit më të moshuar, persona 80 vjeç e lart llogariten rreth 58 mijë në vitin 2011, duke përbërë 2 përqind të të gjithë popullsisë. Ky grup i moshës më të vjetër është segmenti me rritjen më të shpejtë të popullsisë të moshuarve. Deri në vitin 2031, numri i këtij grupi do të jetë rreth 2.2 herë i vitit 2011 dhe do të përbëjë rreth 4.6 përqind të të gjithë popullsisë. Projeksionet e popullsisë sugjerojnë që përqindja e popullsisë së vjetër më të moshuar në të gjithë popullsinë e vjetër (65+) pritet që të rritet duke arritur 31 përqind ose 9 përqind të të gjithë popullsisë në vitin 2060.

Figura 2.7: Popullsia 65 vjeç e lart sipas grupmoshës, 1979-2060 (në mijë)




Burimi: Censuset e popullsisë dhe banesave dhe projeksionet e popullsisë 2011-2060

Numri në rritje i të vjetërve më të moshuar është rezultat i drejtpërdrejtë i jetëgjatësisë në rritje, e cila është vënë re gjatë dekadave të mëparshme dhe që mendohet se do të vazhdojë në dekadat e ardhshme (shihni seksionin 2.4.1). Është një çështje tjetër nëse vitet shtesë të fituara nëpërmjet jetëgjatësisë të rritur jetojnë me shëndet të mirë ose të keq. Të dhënat e Eurostat tregojnë që meshkujt në BE kalojnë përafërsisht 79 përqind të gjithë jetës së tyre në shëndet të mirë pra në mungesë të kufizimeve fizike, sëmundjeve kronike ose shëndetit mendor. Për gratë, kjo përqindje është më e ulët, 74 përqind (2015a). Hendeku gjinor është mjaft më i vogël sa i përket viteve të shëndosha të jetës sesa jetëgjatësia e përgjithshme: meshkuj dhe femra jetojnë shumë kohë me shëndet të mirë dhe vitet shtesë që femrat jetojnë mesatarisht më shumë, i jetojnë më së shumti me kufizime aktivitetshe. Siç tregohet në seksionin 4.4 të këtij raporti, 23 përqind e popullsisë të të moshuarve 65 vjeç e lart vuan nga aftësia e kufizuar, por 42 përqind e më të moshuarve, të moshës 80 vjeç e lart vuan nga aftësia e kufizuar.

2.3.4 Raporti gjinor

Moshimi i popullsisë nuk është “neutral - ndaj- gjinisë”. Vdekshmëria më e madhe e meshkujve gjatë jetës do të thotë që femrat janë më të shumta në numër sesa meshkujt në moshë më të vjetër dhe diferenca është mjaft e gjerë mes të vjetërve më të moshuarve. Mes të gjithë të moshuarve 65 vjeç e lart, ka rreth 91 meshkuj për çdo 100 femra në vitin 2011. Për më të moshuarit 80 vjeç e lart, ka pasur 66 meshkuj për çdo 100 gra. Duke menduar që tendenca të mëparshme të vdekshmërisë do të vazhdojnë, pritet që deri në vitin 2060, të jenë 98 meshkuj për 100 femra të moshës 65 vjeç e lart dhe 77 meshkuj për 100 femra të moshës 80 vjeç e lart.

Figura 2.8: Raporti gjinor i popullsisë 65 vjeç e lart, 1979-2060 (në përqindje)




Burimi: Censuset e popullsisë dhe banesave dhe projeksionet e popullsisë 2011-2060

2.4 PËRCAKTUESIT DEMOGRAFIKË TË MOSHIMIT TË POPULLSISË

2.4.1 Lindshmëria dhe vdekshmëria

Procesi i moshimit të popullsisë njihet si “tranzicion demografik”, një proces sipas të cilit ulja e vdekshmërisë, sidomos në moshë të reja, ndiqet nga ulja e lindshmërisë. Lindshmëria në rënie së bashku me jetëgjatësinë në rritje (Figura 2.9) i ka dhënë trajtë strukturës së moshës së popullsisë duke zhvendosur peshën relative të popullsisë nga grupet më të reja tek ato më të vjetra.

Figura 2.9: Indeksi Sintetik i Fekonditetit (ISF) dhe jetëgjatësia në lindje, 2004-2014




Burimi: Statistikat vitale dhe vlerësime të popullsisë, INSTAT, 2004-2014

Lindshmëria në rënie është shkak i moshimit të popullsisë sepse, ndërsa lindshmëria lëviz në mënyrë të qëndrueshme në nivele më të ulëta, personat në moshë riprodhimi kanë më pak fëmijë krahasuar me ata të brezave më të vjetër, me rezultatin që ulja e lindshmërisë në fakt çon në ulje të përqindjes së fëmijëve dhe të rinjve në një popullsi dhe rritje relative të përqindjeve të grupeve më të vjetra. Ndërsa nivelet e lindshmërisë bien, vdekshmëria ka vazhduar të bjerë, sidomos në moshat më të vjetra. Kur lindshmëria arrin nivele të ulëta dhe mbetet e ulët, ulja e vdekshmërisë në moshë më të vjetra fiton rëndësi dhe si rrjedhim çon në moshimin e popullsisë.


Vdekshmëria ka rënë ndjeshëm gjatë viteve të fundit. Për të dyja gjinitë e kombinuara, fitimi në jetëgjatësinë në lindje ka qenë rreth 4 vjet gjatë 10 viteve të fundit (shihni Figura 2.9). Kjo do të thotë që në këtë periudhë një e/i porsalindur mund të jetojë mesatarisht 4 muaj më shumë se një i/e porsalindur një vit më përpara. Kjo do të thotë që grupmoshat më të vjetra, që ndikohen nga ndryshimi i vdekshmërisë dhe shumë pak nga migracioni, do të jenë më të mëdha, vit pas viti, ndërsa norma e vdekshmërisë ulet. Ky proces ndikon direkt në moshimin e popullsisë.

Figura 2.10 tregon ndryshimet në jetëgjatësi për meshkujt dhe për femrat dhe hendekun gjinor të jetëgjatësisë. Në periudhën 2004-2014, jetëgjatësia e meshkujve është rritur nga 71.6 vjet në 76.4 vjet dhe për femrat nga 77.2 vjet në 80.3 vjet. Në vitin 2014, gratë jetuan më shumë sesa meshkujt me 3.9 vjet mesatarisht. Figura 2.10 tregon që hendeku gjinor i jetëgjatësisë në lindje është ngushtuar gradualisht nga 5.6 në vitin 2004 në 3.9 në vitin 2014.

Figura 2.10: Jetëgjatësia në lindje e meshkujve dhe femrave dhe hendeku gjinor, 2004-2014 (në vite)

Burimi: Statistikat vitale dhe vlerësime të popullsisë

Nga perspektiva e popullsisë së të moshuarve, është e rëndësishme të përcaktohet jetëgjatësia në fillim të fazës së jetës së të moshuarve dhe në moshën kur personat konsiderohen “të vjetrit më të moshuar” nga mosha 80 vjeç e lart. Në një periudhë relativisht të shkurtër 5 vjeçare, janë vënë re përmirësime të ndjeshme në lidhje me jetëgjatësinë në këto mosha. Nëse krahasojmë jetëgjatësinë në periudhën 2005-2009 me atë në periudhën 2010-2014, personat që jetuan dhe u bënë 65 vjeç mund të pritët që të jetojnë mesatarisht 1.3 vjet më shumë në periudhën 2010-2014. Jetëgjatësia për ata që arritën moshën 80 vjeçare u rrit me 0.5 vjet.

Figura 2.11: Jetëgjatësia në moshën 65 dhe 80 në 2005-2009 dhe 2010-2014 (në vite)


Burimi: Statistikat vitale dhe vlerësime të popullsisë

2.4.2 Migracioni

Në rastin e Shqipërisë, përveç lindshmërisë dhe vdekshmërisë, një faktor shumë i rëndësishëm në moshimin e popullsisë është edhe migracioni i lartë dalës i të rinjve. Numri i konsiderueshëm i emigrantëve ka pasur pasoja të rëndësishme për strukturën e popullsisë në Shqipëri. Një nga pasojat e migracionit ndërkombëtar është humbje e rëndë e popullsisë aktuale të të rinjve të rritur. Shifra më poshtë paraqet migracionin neto të vlerësuar për vitin 2011. Ajo tregon që jo të gjitha grupmoshat preken njësoj nga migracioni dhe që më shumë preket popullsia në moshë pune. Humbja e popullsisë përqendrohet fuqishëm në moshat e të rinjve të rritur 20-39 vjeç. Humbja e të rinjve (nën 20 dhe sidomos nën 15) mund të shpjegohet në mënyrë të arsyeshme me emigracionin neto të fëmijëve në varësi së bashku me prindërit e tyre të grupmoshës 20-49 vjeç që emigrojnë.

Shifrat gjithashtu tregojnë që migracioni në moshë më të vjetra nuk prek strukturën e moshës së popullsisë, sepse emigracioni dhe imigracioni e ekuilibrojnë gjerësisht njëra-tjetrën (dhe sidoqoftë janë në nivel të ulët). Sipas vlerësimeve indirekte të emigracionit, shifrat sugjerojnë që 7 mijë persona të moshës 65 vjeç e lart janë kthyer në Shqipëri ndërsa 9 mijë prej tyre kanë emigruar. Sidoqoftë, meqë normat e vdekjes për grupmoshën më të vjetër janë të vështira për t'u matur (Migracioni në Shqipëri 2014c), imigracioni i grupmoshës më të vjetër mund të jetë i pavlefshëm.

Figura 2.12: Migracioni neto i përllogaritur sipas moshës për periudhën 2001-2011




Burimi: Vlerësimi i INSTAT

2.5 DALLIMET RAJONALE

Në vitin 2011, personat 65 vjeç e lart përbëjnë rreth 11 përqind të të gjithë popullsisë. Në të gjitha qarqet, kjo përqindje e të moshuarve ka ndryshuar nga një minimum 8 përqind në Kukës në një maksimum 14 përqind në Gjirokastrë. Kjo përqindje e ulët e të moshuarve në rastin e Kukësit lidhet me një indeks relativisht të lartë sintetik të fekonditetit krahasuar me qarqet e tjera. Gjirokastra ka një nivel relativisht të ulët të lindshmërisë dhe përveç kësaj ka norma të larta emigracioni.

Në vitin 2031, përqindja e të moshuarve pritet që të jetë mbi 20 përqind në të gjitha qarqet përveç Tiranës, për shkak të fluksit hyrës të vazhdueshëm të të rinjve të rritur nga qarqe të tjera, që kërkojnë arsim dhe punësim.

Figura 2.13: Përqindja e popullsisë 65 vjeç e lart, sipas vitit të censurit dhe sipas qarkut




Burimi: Censuri i Popullsisë dhe Banesave 2011 dhe projeksionet e popullsisë 2011-2031

Në një perspektivë rajonale, raporti total i varësisë varion disi ndërmjet qarqeve, duke ndryshuar nga 43 në Tiranë me një popullsi relativisht të madhe në moshë pune, në 56 në Kukës. Megjithatë, dallimet në raportet e përbëra të varësisë specifike për moshën janë më të shprehura. Gjirokastra (25 përqind) dhe Korça (27) dallohen me raporte varësie të ulëta të të rinjve, dhe Dibër (38) dhe Kukës (43) me raporte më të larta.

Raportet e varësisë së të moshuarve, sidomos në lidhje me këto qarqe të veçuara, paraqesin situatën e përmbysur: vlerat më të larta vërehen në Gjirokastrë (24 përqind) dhe Korçë (21) dhe më të ulëtat në Dibër (14) dhe Kukës (12). Kjo do të thotë që për këto qarqe, shumica e popullsisë në varësi në grupin e fundit (Dibër dhe Kukës) përbëhet nga fëmijët; dhe për grupin e parë (Korçë dhe sidomos Gjirokastrë) nga një numër më i madh i të moshuarve.


Figura 2.14: Raportet e varësisë sipas qarqeve, 2011



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

Duke pasur parasysh tendencat e ardhshme të lindshmërisë, vdekshmërisë dhe lëvizjeve të popullsisë ne mund të presim dallime të rëndësishme mes qarqeve për raportin e varësisë së të moshuarve. Në vitin 2031, qarku me raportin e varësisë më të lartë të të moshuarve do të jetë Gjirokastra me 45 të moshuar për çdo 100 persona të moshës 15 deri në 64 vjeç. Qarku me raportin e varësisë më të ulët të të moshuarve do të jetë Tirana me 30 përqind, për shkak të lëvizjes së popullsisë në moshë pune (15-64) drejt qendrave ekonomike dhe arsimore të Shqipërisë, pra Tiranë.

Figura 2.15: Raporti i varesisë së të moshuarve i projektuar, sipas qarkut 2031



Burimi: Projektionet e popullsisë 2011-2031

3 NJËSIA EKONOMIKE FAMILJARE DHE KUSHTET E JETESËS

3.1 HYRJE

Transformimi social dhe demografik që ka kaluar Shqipëria gjatë dekadave të fundit ka pasur ndikim të madh në familje dhe në jetesën në njësi ekonomike familjare. Shumë ndryshime- edhe pse jo të gjitha- janë në përputhje me Tranzicionin e Dytë Demografik (TDD) që vërehet në shumë vende të tjera europiane. Zhvendosja drejt individualizmit dhe shoqërive më të hapura dhe të pasura ndikon jo vetëm në proceset bazë demografike të lindshmërisë, vdekshmërisë dhe migracionit, të cilat janë në themel të proceseve të moshimit dhe plakjes në Shqipëri (shihni kapitullin 2), por edhe në zhvillime të tjera si ndryshime në modelin e martesës dhe sistemimit në banesë dhe në emancipimin e grave (Van de Kaa 2002, Lesthaeghe, Neidert Surkyn 2007, Lesthaeghe 2010). Ndërsa të rinjtë janë zakonisht në pararojë të këtij procesi ndryshimi, në një masë më të vogël ai prek edhe jetën e të moshuarve. Ky kapitull përdor të dhënat e censurit të vitit 2011 për të eksploruar sistemimin në njësi ekonomike familjare në Shqipëri, sidomos nëpërmjet këndvështrimit të popullsisë të të moshuarve. Seksioni 3.2 përshkruan përbërjen e njësive ekonomike familjare dhe pozicionin e të moshuarve në familje dhe seksioni 3.3 fokusohet në gjendjen civile të personave më të moshuar dhe ndryshimet e kësaj gjendjeje gjatë procesit të moshimit.


Gjithashtu ky kapitull jep informacion për kushtet e jetesës së të moshuarve, në kuptimin e mirëqenies materiale, varfërisë dhe aksesit në kushte specifike strehimi (seksioni 3.4). Për informacionin në lidhje me varfërinë, analiza bazohet në Anketën e Matjes së Nivelit të Jetesës (AMNJ) të vitit 2012. Kur e lejon disponueshmëria e të dhënave të censurit të mëparshëm dhe nëse është me vend, paraqiten edhe ndryshimet në sistemimin në njësi ekonomike familjare dhe kushtet e jetesës.

3.2 MADHËSIA DHE STRUKTURA E NJËSISË EKONOMIKE FAMILJARE

Censuset e njëpasnjëshme në Shqipëri treguan një rritje të shpejtë të popullsisë deri në vitin 1989 si pasojë e një rritjeje të lartë natyrore në sistemin e mbyllur të migracionit (*Figura 3.1*). Megjithatë, censuset e njëpasnjëshme të vitit 2001 dhe 2011 tregojnë rënie të ndjeshme në madhësinë e popullsisë për shkak të një kombinimi të lindshmërisë në rënie dhe emigracionit masiv (shihni kapitullin 2). Numri i njësive ekonomike familjare nuk është zhvilluar në përputhje me numrin e personave në këto periudha. Ai është rritur me normë më të lartë sesa popullsia në dekadat përpara vitit 1989 dhe madje është rritur ose stabilizuar kur shifrat e popullsisë janë ulur pas atij viti. Si rezultat, madhësia mesatare e njësive ekonomike familjare ka rënë vazhdimisht që në vitin 1969.

Në vitin 1989, pothuajse dy të tretat (66 përqind) e popullsisë ka jetuar në njësi ekonomike familjare me pesë ose më shumë persona; në vitin 2011 është ulur në gjysmën (50 përqind) e popullsisë. Në të njëjtën mënyrë, përqindja e personave që jetojnë në njësi ekonomike familjare me një ose dy persona është më shumë se dyfishuar nga 5.3 në 12.7 përqind. Përveç ndikimeve të lindshmërisë së ulët dhe numrit më të ulët të fëmijëve në njësi ekonomike familjare, kjo ka ndodhur edhe për shkak të një ndryshimi në jetesë për segmente të ndryshme të popullsisë. Rastet e njësive ekonomike familjare të përbëra dhe me shumë breza janë më të rralla, duke u ulur nga rreth 20 përqind në vitin 1989 në 10 përqind në vitin 2011.


Figura 3.1: Madhësia e popullsisë, numri i njësive ekonomike familjare dhe madhësia mesatare e njësive ekonomike familjare, sipas vitit të censurit



Burimi: Censuri i Popullsisë dhe Banesave 1969 - 2011

Ulja e madhësisë së njësive ekonomike familjare është e dukshme në situatën e jetesës së të moshuarve. Në periudhën e fundit ndërmjet censuseve, madhësia mesatare e njësive ekonomike familjare të personave të moshuar ka rënë nga 4.2 në 3.9 persona, ndryshim ky i njëjtë si ai për të gjithë popullsinë në Shqipëri. Përqindja e të moshuarve që ka jetuar në njësi ekonomike familjare të mëdha prej pesë ose më shumë persona ka rënë nga 49 në 42 përqind në këtë periudhë (Figura 3.2). Sistemi më i zakonshëm sa i përket madhësisë së njësive ekonomike familjare tani është njësi ekonomike familjare me dy persona (30 përqind). Përqindja që jeton vetëm është rritur pak në terma relative (7.6 përqind në vitin 2011 krahasuar me 7.2 përqind në vitin 2001), por është rritur me pothuajse gjysmën nga 16.8 mijë në 24.3 mijë në të njëjtën periudhë.

Figura 3.2: Popullsia e të moshuarve 65 vjeç e lart sipas vitit të censurit dhe sipas madhësisë së njësive ekonomike familjare



Burimi: Censuri i Popullsisë dhe Banesave 2001 dhe 2011

Përqindja e të moshuarve që jetojnë në njësi ekonomike familjare me shumë familje ka rënë nga 30 përqind në vitin 2001 në 19 përqind në vitin 2011. Nga ana tjetër, përqindja e familjeve që jeton si çift pa fëmijë është rritur nga 24 në 32 përqind në të njëjtën dekadë ndërmjet censuseve. Ky zhvillim ndoshta është rezultat i faktorëve të kombinuar, përfshirë një stok më të madh strehimi dhe tërheqjen më të madhe për privaci dhe pavarësi në procesin e individualizimit në shoqëri (cf. Grundy 2001). Vëzhgimi që më shumë persona të moshuar vazhdojnë të jetojnë si cist gjithashtu rezulton nga rritja e jetëgjatësisë (shihni seksionin 2.41.), që i lejon njerëzit të kalojnë më shumë vite së bashku.

Situata e të moshuarve që jetojnë të pavarur, vetë ose në çift, është një nga treguesit e një projekti për moshimin e shëndetshëm për të matur potencialin e pashfrytëzuar të të moshuarve për moshim aktiv dhe të shëndetshëm në mbarë vendet.² Megjithatë, vëzhgimi i të moshuarve që jetojnë të pavarur nuk tregon nëse ky është sistemimi i dëshiruar dhe në çfarë mase të moshuarit do të kishin nevojë për mbështetje në jetesën e përditshme.

Nga perspektiva e mbështetjes për personat e moshuar, prezenca e një anëtarit të rritur të njësisë ekonomike familjare më të ri se 65 vjeç mund të jetë veçanërisht e rëndësishme. Shumica prej 71 përqind ka një ose më shumë persona të rritur në njësi ekonomike familjare. Për meshkujt e moshuar kjo përqindje është disi më e lartë sesa për femrat: 74 kundrejt 68 përqind. Një arsye për këtë dallim gjinor është moshë përgjithësisht më e re e grave në martesë. Për të moshuarit më të vjetër (80 vjeç e lart), që mesatarisht kërkojnë më shumë mbështetje, përqindja e atyre që kanë të paktën një anëtar të rritur në njësinë ekonomike familjare nën moshën 65 vjeç është më e lartë (80 përqind). Kjo tregon që 20 përqind e të vjetërve më të moshuar - 29 përqind për meshkuj dhe 15 përqind për femra - nuk mund të bazohet në një anëtar më të ri të njësisë ekonomike familjare.

Krahasuar me situatën e paraqitur në censusin e vitit 2001, përqindja e të moshuarve që jetojnë pa anëtarë të rinj të rritur në njësi ekonomike familjare është rritur. Megjithatë, ky ndryshim vërehet vetëm për të moshuarit 65 deri në 79 vjeç, për të cilët përqindja është rritur nga 24 në 29. Për të vjetrit më të moshuar, situata ka mbetur e njëjtë, sepse në vitin 2001 rreth 19 përqind nuk kanë anëtar të ri të rritur në njësinë ekonomike familjare.


Personat më të vjetër që jetojnë vetë rrezikojnë më shumë të përfuturin izolim social dhe deprivim ekonomik dhe prandaj mund të kërkojnë mbështetje të veçantë. Në Shqipëri, numri i të moshuarve që jetojnë tërësisht vetë është rritur që në vitin 2001. Në këtë kohë, 5 përqind e të moshuarve ka jetuar në njësi ekonomike familjare me një person, duke u rritur në 8 përqind në vitin 2011. Në terma absolute, shifrat janë rritur nga 16.8 mijë në vitin 2001 në 24.3 mijë në vitin 2011. Për shkak të mbijetesës së lartë dhe moshës më të ulët të martesës, gratë më të vjetra ka më shumë mundësi që të jetojnë vetë: 77 përqind e të moshuarve që jetojnë vetë (18.6 mijë persona) janë gra.

Gjatë fazës së jetës së të moshuarve, pozicioni i personave në njësinë ekonomike familjare ndryshon ndjeshëm dhe ndryshon në mënyra të ndryshme për meshkujt dhe femrat. Shumica e meshkujve arrijnë moshën 65 vjeç si kryefamiljarë, ose me një ose me më shumë fëmijë që jetojnë me atë, ose vetëm me bashkëshorten e tyre. Me moshimin, një përqindje e madhe e tyre konsiderohet më shumë në varësi zakonisht të familjes së një fëmije me të cilin jetojnë (Figura 3.3). Ky ndryshim ndodh nëse një mashkull jeton me familjen e fëmijës së tij ose nëse në një moment të caktuar në kohë, pozicioni i kryefamiljari i kalon djalit. Megjithatë, edhe në moshat më të vjetra, shumica e meshkujve akoma konsiderohen kryefamiljarë, edhe nëse ata - dhe bashkëshortet e tyre - jetojnë së bashku me fëmijët e rritur të cilët ndoshta sigurojnë të ardhurat kryesore të njësisë ekonomike familjare.

Nga ana tjetër, femrat rrallë konsiderohen kryefamiljare, përveçse kur janë vejusha dhe jetojnë vetë. Shumica e grave të moshuara konsiderohen ose grua ose mamaja e një kryefamiljari. Me moshimin, pozicioni i tyre zakonisht zhvendoset nga pozicioni i parë në njësinë ekonomike familjare tek pozicioni i dytë, në varësi të faktit nëse bashkëshorti i tyre jeton.

2 <http://www1.unece.org/stat/platform/display/AAI/Active+Ageing+Index+Home>

Figura 3.3: Popullsia e të moshuarve, meshkuj dhe femra, 65 vjeç e lart, sipas lidhjes me kryefamiljarin dhe sipas moshës (në përqindje)



Burimi: Censuri i Popullsisë dhe Banesave 2011


Krahasuar me situatën në vitin 2001, dallimi më i dukshëm është që në këtë kohë meshkujt vazhdojnë të konsiderohen edhe më shumë si kryefamiljarë. Ky pozicioni i korrespondon 95 % të meshkujve të moshës 65-69 vjeç, duke u ulur në 65 përqind për të moshuarit 90 vjeç e lart. Kështu, përqindja që është zhvendosur në pozicion nga kryefamiljari në pozicionin në varësi është rritur nga 4 në 30 përqind vetëm në grupmosha të moshuara të njëpasnjëshme.

3.3 GJENDJA CIVILE

Martesa është parim universal në Shqipëri. Vetëm së fundmi- edhe pothuajse ekskluzivisht mes të rinjve të rritur- janë vënë re ndryshime në kuptimin e përqindjeve të dukshme të atyre që mbeten jashtë martese dhe norma të ulëta të rimartesës (INSTAT 2014a). Mes persona të vjetër të moshës 65 vjeç e lart, këto ndryshime nuk janë akoma të dukshme. Më shumë se 98 përqind e të moshuarve kanë qenë të martuar dhe ata pak që mbeten zakonisht nuk janë martuar për shkak të problemeve të rënda shëndetësore (shihni gjithashtu seksionin 4.4 të këtij raporti). Gjithashtu, norma e divorceve është mjaft e ulët në Shqipëri dhe zgjidhja e martesës më së shumti ka ndodhur për shkak të vdekjes së bashkëshortes/bashkëshortit. Për rrjedhojë, të gjithë të moshuarit ose janë martuar (67 përqind) ose kanë mbetur të ve (31 përqind).

Shpërndarja e kësaj gjendjeje civile është mjaft e ndryshme në moshë më të vjetra të meshkujve dhe grave (Figura 3.4). Pothuajse gjysma (48 përqind) e të gjitha grave të moshuara janë vejusha, kjo më së shumti si pasojë e një jetëgjatësie më të ulët të meshkujve (shihni seksionin 2.3.1 të këtij raporti) dhe dallimit në moshë ndërmjet bashkëshortëve. Mes grave më të moshuara 80 vjeçare e lart, 76 përqind janë vejusha. Nga ana tjetër, 87 përqind e meshkujve të moshuar mbeten në martesë sepse zakonisht gratë e tyre më të reja jetojnë më shumë se ata dhe për shkak të normës së lartë të rimartesës në rast të zgjidhjes së martesës (INSTAT 2014a). Vetëm në moshë shumë të avancuara, përqindja e meshkujve të ve bëhet më e ndryshme. Rrjedhimisht, janë veçanërisht gratë e moshuara në Shqipëri ato që mbeten pa mbështetje praktike dhe emocionale që zakonisht ofrohet nga lidhja në martesë.

Figura 3.4: Popullsia e të moshuarve, meshkuj dhe femra, të moshës 65 vjeç e lart, sipas gjendjes civile dhe sipas moshës (në përqind)



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

3.4 KUSHTET E JETESËS SË TË MOSHUARVE

3.4.1 Të moshuarit dhe varfëria

Për Shqipërinë, Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (AMNJ) jep informacion për vlerësimin e nivelit të varfërisë në vend. Personat dhe njësitë ekonomike familjare konsiderohet se jetojnë në kushte varfërie nëse shporta e mallrave dhe shërbimeve që ata konsumojnë është e pamjaftueshme për të ofruar nivelin minimal të mirëqenies materiale, kufirin e varfërisë. Edhe pse duhet pranuar që varfëria e matur me konsumin për frymë është qartazi një masë vetëm për mirëqenien ekonomike, ndikimi i saj përfshin dukshëm dimensionet më të mëdha, ashtu si në shumicën e situatave, konsumi lidhet ngushtë me dimensione të tjera të mirëqenies, siç janë arsimi ose shëndeti. Shumica e të moshuarve varen nga pensioni, i cili zakonisht siguron një nivel të pamjaftueshëm të ardhurash. Megjithatë, shumë të moshuar jetojnë me fëmijët e tyre, sidomos në moshë të madhe. Në këtë situatë, ata ndajnë të ardhurat e përgjithshme të njësisë ekonomike familjare.

Sipas të dhënave të AMNJ 2012, vlerësohet që 10 përqind e popullsisë të moshës 65 vjeç e lart ka qenë e varfër dhe nuk ka plotësuar standardet bazë të jetesës. Masa në të cilën këta të moshuar të varfër mesatarisht nuk arrijnë nivelin e konsumit që konsiderohet minimumi për standarde bazë të jetesës është vetëm 2 përqind. Kjo do të thotë që “përqindja e varfërisë” të të moshuarve të varfër mesatarisht nuk ka qenë shumë e madhe, ose më fjalë të tjera, të moshuarit e varfër në Shqipëri, janë mesatarisht, nën linjën e varfërisë.³ Përqindja relativisht e ulët e varfërisë tregon që vlera monetare që kërkohet për të ngritur të varfrin mbi linjën e varfërisë është relativisht e vogël: me mjetet e kufizuara shumë të moshuar të varfër mund të ngrihen në statusin e jo të varfërve.

Nuk ka të dhëna nga AMNJ në dispozicion për të dhënë informacion për tendencat e varfërisë për periudhë më të gjatë kohe. Megjithatë, të dhënat e censurit përfshijnë disa masa të mirëqenies materiale duke dhënë informacion për zotërimin pajisjeve afatgjata të njësisë ekonomike familjare. Figura 3.5 tregon përqindjen e personave 65 vjeç e lart që kanë pasur në zotërim pajisje të cilat janë përfshirë në censurin e vitit 2011 dhe në censurin e vitit 2001, aq sa kanë qenë në dispozicion.


Figura për vitin 2011 tregon një disponueshmëri relativisht të madhe të pajisjeve të njësisë ekonomike familjare, si frigoriferë, TV dhe makina larëse. Por zotërimi i pajisjeve më luksoze- për shembull, mikrovala, kondicionerë, ngrirës, pjatolarëse dhe makinë tharëse- ka qenë më i rrallë dhe tregon standardet e rënda të jetesës për shumë të moshuar. Edhe kompjuterët dhe lidhja me internet nuk ka qenë në dispozicion për një numër të madh të moshuarish, gjë kjo

³ Pabarazia mes të moshuarve të varfër është gjithashtu relativisht e ulët (ashpërsia e varfërisë është më pak se 1) gjë kjo që teknikisht nuk është e mundur me një përqindje relativisht të ulët të varfërisë.

që kufizon aksesin e mjaftueshëm në informacion. Po kështu, vetëm një në pesë të moshuar ka pasur në zotërim një makinë, gjë kjo që tregon kufizim sa i përket lëvizshmërisë fizike.

Pavarësisht normave modeste të zotërimit të shumë objekteve të njësisë ekonomike familjare, krahasimi me situatën e vitit 2001 tregon përmirësim të ndjeshëm. Në atë kohë, të moshuarit kishin frigorifer dhe TV, por për të gjitha objektet e tjera që ishin përfshirë në pyetësin e 2001, disponueshmëria është zgjeruar më shumë. Komunikimi dhe teknologjia moderne e informacionit- telefonat celularë, kompjuterët dhe lidhja me internet- nuk kanë qenë në dispozicion për të moshuarit në vitin 2001 ose nuk kanë qenë të renditura në pyetësin e censurit sepse në atë kohë nuk janë konsideruar relevante. Në veçanti, zotërimi i një telefoni celular është rritur në mënyrë spektakolare në 83 përqind në vitin 2011.

Figure 3.5: Popullsia e të moshuarve 65 vjeç e lart, sipas censurit dhe sipas zotërimit të pajisjeve afatgjata (në përqindje)^a




Burimi: Censuri i Popullsisë dhe Banesave 2001 dhe 2011

a Sendet 'n/a' nuk janë renditur në pyetësin e censurit 2001 dhe për rrjedhojë nuk ka të dhëna në dispozicion.

3.4.2 Kushtet e strehimit

Shtëpitë e veçuara janë njësitë më të zakonshme të strehimit të banuara nga personat e moshuar në Shqipëri, Sipas censurit të vitit 2011, rreth 58 përqind jetojnë në këtë lloj strehimi, ndërsa një përqindje më e vogël jeton në shtëpi që janë në një varg me dy (gjysmë të veçuara, 10 përqind) ose më shumë shtëpi (shtëpi në varg, 4 përqind) (Figura 3.6). Një tjetër përqindje e konsiderueshme e të moshuarve (28 përqind) jetojnë në apartamente. Kjo përqindje është rritur disi krahasuar me censurin e mëparshëm në vitin 2001, kur ka qenë 24 përqind e të gjithë të moshuarve.

Figura 3.6: Popullsia e të moshuarve 65 vjeç e lart, sipas llojit të njësisë së strehimit (në përqindje)

Censuri i Popullsisë dhe Banesave, 2011

Edhe pse ndërtesat apartament mund të kenë disa avantazhe ndaj shtëpive të veçuara, një disavantazh mund të jetë mungesa e një ashensori në ndërtesë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për të moshuarit, që mund të kenë më shumë probleme me ngjitjen e shkallëve. Më shumë se gjysma (51 përqind) e personave 65 vjeç e lart kanë vështirësi me ecjen dhe ngjitjen e shkallëve dhe 15 përqind ka kufizime fizike në këtë drejtim. Për më të moshuarit 80 vjeç e lart, këto përqindje janë edhe 91 dhe 29 përqind (shihni seksionin 4.4 të këtij raporti). Rreth 80 përqind të të moshuarve që jetojnë në apartamente- 73 mijë persona- vuajnë mungesën e ashensorit në ndërtesë. E njëjta përqindje zbatohet për më të moshuarit 80 vjeç e lart që jetojnë në një apartament - 15 mijë persona- që kanë mesatarisht edhe më shumë vështirësi në ngjitjen e shkallëve. Këto kushte strehimi për shumë prej tyre mund të kufizojnë ndjeshëm aksesin e tyre në shërbimet dhe pjesëmarrjen në shoqëri. Megjithatë, krahasuar me vitin 2001, situata është përmirësuar, sepse në atë kohë, përqindja e të moshuarve që jetojnë në apartamente të cilat nuk kanë ashensor ka qenë 97 përqind.

Shumica prej 79 përqind e të moshuarve janë pronar të ndërtesës ku jetojnë. 15 përqind të tjerë janë në proces të marrjes së aktit të ligjshëm të banesës. Vetëm 6 përqind jetojnë në banesë si qiramarrës ose banues pa paguar qira.

3.4.3 Shfrytëzimi i banesës

Nëse shumë persona ndajnë një banesë, kjo mund të ketë ndikim negativ në mirëqenien e tyre. Në fakt mbipopullimi është shfaqje e pabarazisë së strehimit dhe është gjithashtu një formë e fshehur e të qenit të pastrehë. UN- Habitat përkufizon mbipopullimin si banesa me tre ose më shumë persona në një dhomë (UN-Habitat 2007). Pasojat e mbipopullimit përfshijnë një risk më të madh të transmetimit të sëmundjeve për një gamë të gjerë të sëmundjeve të rrugëve të frymëmarrjes, përfshirë pneumoninë, tuberkulozin dhe shumë alergji dhe sjellje sociale negative, si dhuna në familje. Nga ana tjetër, banesat ku banojnë më pak se një person në dhomë mund të konsiderohen “të nën-banuara” dhe nëse kjo ndodh në shkallë të gjerë, tregon një funksionim të dobët të tregut të shtëpive. Për Shqipërinë, banesat me 1 deri në 2.9 persona në dhomë konsiderohen “të banuara mjaftueshëm” dhe banesat me tre persona ose më shumë në dhomë përkufizohen “të mbipopulluara”.


Nëse konsiderohet ky përkufizim i mbipopullimit, vërehet përmirësim i ndjeshëm ndërmjet vitit 2001 dhe 2011. Përgjithësisht, përqindja e banesave të mbipopulluara në vitin 2001 është rreth një e katërta e asaj të vitit 2001, 3.8 dhe 16.5 përqind përkatësisht. Nga ana tjetër, aktualisht ka 2.4 herë më shumë banesa të nën-banuara në vitin 2011 krahasuar me 10 vjet më parë, kjo si rezultat i një sërë faktorësh që përfshijnë modele të reja të jetesës për njësitë ekonomike familjare në Shqipëri, shpopullim të disa qarqeve në vend, por ndoshta edhe mbi-prodhim të sektorit të strehimit.

Rënia e përqindjes së të moshuarve që jetojnë në banesë të mbipopulluar ka qenë me shkallë të njëjtë me rënien e përgjithshme nga 17 përqind në vitin 2001 në 5 përqind në vitin 2011. Kjo tendencë në rënie e të moshuarve që

jetojnë në banesa të mbipopulluara është vënë re në të gjitha qarqet.

Në vitin 2011, përqindja më e lartë e të moshuarve që jetojnë në një banesë të mbipopulluar është vënë re në qarkun e Dibrës (11.3 përqind), ndjekur nga qarku i Kukësit (10.9 përqind) siç tregohet në *Figurën 3.7* më poshtë. Këto përqindje të larta ka mundësi që të lidhen me rënien më të ngadaltë në normat e lindshmërisë në këto zona (shihni p.sh INSTAT 2004). Qarku i Gjirokastrës ka pasur përqindjen më të ulët të të moshuarve që jetojnë në banesë të mbipopulluar (2.4 përqind), që ka ndodhur të paktën pjesërisht për shkak të migracionit të lartë dalës nga ky qark (shihni gjithashtu kapitullin 2). Gjerësisht, i njëjti model është vënë re në vitin 2001, ku qarku i Kukësit dhe Dibrës kanë pasur nivelin më të lartë të mbipopullimit me 25 dhe 23 përqind, përkatësisht. Edhe pse këto qarqe akoma kanë nivele më të larta mbipopullimi, rënia ka qenë më e madhja e të gjitha qarqeve në Shqipëri. Në këtë kohë, përqindja më e ulët e të moshuarve që në një banesë të mbipopulluar është vënë re në Korçë (11 përqind).

Figura 3.7: Përqindja e popullsisë të moshuar 65 vjeç e lart që jeton në banesë të mbipopulluar, sipas vitit të censurit dhe qarkut




Burimi: Censuri i Popullsisë dhe Banesave 2001 dhe 2011

3.4.4 Uji dhe higjiena

Higjiena bazë që ofron uji i pijshëm i sigurt dhe tualetet janë strategjitë më të efektshme për të përmirësuar dhe ruajtur statusin shëndetësor të popullsisë. Ka të dhëna që ofrimi në nivel global i shërbimeve të mjaftueshme të higjienës, furnizimi i sigurt me ujë dhe edukimi për higjienë përfaqëson një ndërhyrje të efektshme shëndetësore që ul vdekshmërinë e shkaktuar nga sëmundje të diarresë me mesatarisht 65 përqind dhe vdekshmërinë me 26 përqind (OBSh, 2001). Nisur nga kushtet shëndetësore përgjithësisht delikate të të moshuarve, shërbimet e duhura janë veçanërisht të rëndësishme. Si për sistemin e furnizimit me ujë ashtu edhe për sistemin e kanalizimeve, nuk ka rëndësi vetëm lloji i tualetit, por edhe të pasurit e tualetit brenda banesës.

Në Shqipëri, shumica e të moshuarve ka pasur akses në sisteme të sigurta të furnizimit me ujë në censusin e vitit 2011. Për shumicën (86 përqind) uji i tubacionit dhe i sigurt është siguruar, por vetëm 65 përqind ka patur akses të menjëhershëm brenda ndërtesës (*Figura 3.8 pjesa a*). Rreth 12 përqind kanë pasur akses në sisteme të tjera të furnizimit me ujë, si puse ose depozita uji, me cilësi të pa garantuar uji. Një pakicë prej 3 përqind, nuk ka pasur aspak akses në furnizimin me ujë në afërsi të ndërtesës. Edhe pse furnizimi me ujë ka qenë larg nivelit të mjaftueshëm në vitin 2011, ka pasur përmirësim të konsiderueshëm krahasuar me vitin 2001, kur vetëm 77 përqind e të moshuarve ka pasur akses në ujin e tubacionit dhe më pak se gjysma (47 përqind) ka pasur ujë tubacioni brenda ndërtesës. Në atë kohë, vetëm 11 përqind nuk ka pasur aspak furnizim me ujë në afërsi. Situata e furnizimit me ujë madje është përmirësuar - disi- për popullsinë e të moshuarve më shumë sesa për të gjithë popullsinë.

Figura 3.8: Shpërndarja e (a) furnizimit me ujë dhe (b) tualeti për popullsinë e të moshuarve 65 vjeç e lart, sipas vitit të censurit dhe llojit të tualetit (në përqindje)



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2001 dhe 2011


Kushtet e tualetit të të moshuarve tregojnë një panoramë të njëjtë si situata e furnizimit me ujë. Shumica prej 93 përqind ka akses në lloj të përmirësuar tualeti, por vetëm 76 përqind ka pasur tualet brenda ndërtesës (Figura 3.8, pjesa b). Rreth 6 përqind ka një lloj të ndryshëm tualeti, për të cilin nuk dihet sa i përshtatshëm është. Një përqindje pothuajse e pandjeshme nuk ka aspak akses në tualet (më pak se 1 përqind). Krahësuar me vitin 2001, mund të vërehet përmirësim i ndjeshëm. Në atë kohë, vetëm 70 përqind e të moshuarve ka akses në tualet me ujë të rrjedhshëm dhe vetëm 55 përqind ka pasur tualet brenda ndërtesës së tyre. Edhe për higjienën, kushtet për popullsinë e moshuar janë përmirësuar disi më shumë sesa për të gjithë popullsinë.

3.4.5 Ngrohja e banesës

Ngrohja e duhur nuk është e rëndësishme vetëm për të shmangur kushtet e të ftohtit në banesë, por edhe lloji i ngrohjes është një faktor në barrën e detyrave të shtëpisë, për shembull për shkak të nevojës së përditshme për të siguruar dhe marrë dru zjarri. Gjithashtu, lloje specifike të ngrohjes mund të kenë ndikim negativ në kushtet e shëndetit të pjesëtarëve të njësive ekonomike familjare. Përdorimi i lëndës ngrohëse të ngurtë - si druri i zjarrit - zakonisht rezulton në djegie të paplotë dhe rrjedhimisht në lëshimin e qindra komponentëve, shumë prej të cilave shkaktojnë kancer dhe probleme të tjera shëndetësore dhe kontribuojnë në ndryshimin e klimës në botë.

Dy të tretat e të moshuarve në Shqipëri në vitin 2001 ngroheshin me sobë druri, e cila është lloji i ngrohjes me disavantazhin e përmendur të barrës fizike të sigurimit të drurit të zjarrit, si edhe mjaft e rrezikshme për shëndetin (Figura 3.9). Kjo vlen edhe për përdorimin e një vatre si mënyrë për të ngrohur banesën, që është praktikuar nga një tjetër 6 përqind i të moshuarve. Ngrohja me energji - kondicioner dhe ngrohës elektrik - ofron ngrohje për një në tetë persona të moshuar (13 përqind). Ngrohja qendrore - ose qendrore në ndërtesë ose në banesë - ka qenë më pak e përdorur dhe më shumë e përdorur në zona urbane. Megjithatë, ngrohja qendrore e përdorur nga 3 përqind e të moshuarve nënkupton një rritje nga vetëm 1 përqind në vitin 2001. Rreth 5 përqind e të moshuarve ka jetuar në ndërtesë pa ngrohje.

Figura 3.9: Popullsia e moshuar 65 vjeç e lart sipas llojit të ngrohjes në banesë (në përqindje)



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

4 SHËNDETI

4.1 HYRJE


Deri së fundmi, popullsia e moshuar e personave 65 vjeç e lart ka përbërë një përqindje shumë të vogël të popullsisë shqiptare dhe vëmendja nga këndvështrimi shëndetësor ka qenë e ulët. Megjithatë, tranzicioni demografik që ka ndodhur në Shqipëri tregon që popullsia e moshuar do të rritet shpejt në shifra absolute dhe në përqindje të gjithë popullsisë. Rritja e pritshme është nga 318 mijë në vitin 2011 (11 përqind) në 581 mijë në vitin 2030 (21 përqind). Sëmundjet kronike ndikojnë në mënyrë jo proporcionale të rriturit e moshuar (de Jong- Gierveld dhe van Solinge 1995: Holiday 1999) dhe lidhen me aftësitë e kufizuara, cilësinë e ulur të jetës dhe kostot e rritura për kujdesin shëndetësor dhe kujdesin afatgjatë. Rrjedhimisht, shëndeti do të bëhet një çështje politikash gjithnjë e më shumë e rëndësishme.

Informacioni shëndetësor për të moshuarit në Shqipëri është i pakët. Tre burime kryesore informacioni kanë qenë në dispozicion për të vlerësuar situatën e shëndetit të të moshuarve. I pari është Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011, i cili për herë të parë ka përfshirë një grup pyetjesh për aftësitë e kufizuara funksionale. Të tjerët janë anketa e zhvilluar në 2007-08 nga Shoqata Shqiptare e Gjeriatriisë dhe Gjerontologjisë në rrethet e Tiranës, Shkodrës dhe Vlorës (Ylli 2010) dhe Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (AMNJ) që zhvillohet rregullisht nga INSTAT.

4.2 SHËNDETI I VETË-VLERËSUAR

Studimi nga Shoqata Shqiptare e Gjeriatriisë dhe Gjerontologjisë në 2007-08 i kërkon të pyeturve të moshuar (65 vjeç e lart) që të vlerësojnë gjendjen e tyre shëndetësore. Rreth 32 përqind e të moshuarve vlerësojnë veten të pasëndetshëm dhe 10 përqind madje me shëndet të keq (Figura 4.1). Kjo është më shumë sesa përqindja e kundërt që konsideron veten në shëndet të mirë ose shumë të mirë (së bashku 29 përqind). Përqindja e të gjithë të pyeturve që raportojnë se vuan nga një sëmundje kronike ka qenë 77 përqind. Rreth gjysma e të moshuarve raportojnë sëmundje kardiovaskulare dhe 19 përqind raportojnë diabetin.

Figura 4.1: Të moshuarit 65 vjeç e lart, sipas vetë vlerësimit të gjendjes shëndetësore (në përqindje)



Burimi: Ylli 2010

Më shumë se një e treta (27 përqind) e të moshuarve raportojnë që nuk u ofrohet kujdes shëndetësor kur kanë nevojë. Mes arsyeve kryesore për këtë janë vështirësitë për të përballuar trajtimin mjekësor (20 përqind) dhe, në masë më të vogël, distanca me shërbimet e kujdesit shëndetësor (4 përqind) dhe sëmundja veçanërisht e rëndë, që bën të pamundur për të moshuarit që të shkojnë tek doktori (3 përqind). Rreth dy të tretat (69 përqind) e të moshuarve gjithashtu raportojnë që nuk kanë pasur mundësi të sigurojnë medikamente të efektshme që jep mjeku i familjes, për arsyen kryesore që nuk mund të përballojnë ilaçet. Strategjitë për ta zgjidhur këtë përfshijnë zgjedhjen e ilaçeve më pak të efektshme ose mbështetjen tek anëtarët e familjes.


4.3 DUHANI DHE PËRDORIMI I ALKOOLIT

Organizata Botërore e Shëndetit ka identifikuar duhan pirjen si një shkak i rëndë i sëmundjes së parakohshme dhe vdekjes: është shkaku i vetëm më i parandalueshëm i vdekshmërisë para kohe. Ndikimi i kombinuar i nikotinës (droga kryesore që gjendet në duhan) dhe gazeve të tjera që hyjnë në mushkëri gjatë duhan pirjes rrit ndjeshëm rrezikun e sëmundjeve, përfshirë kancerin dhe sëmundjet e zemrës. Gjithashtu pranohet që duhan pirja pasive ose dytësore mund të rrezikojë shëndetin e të tjerëve. Kjo është një nga arsyet pse duhan pirja është ndaluar me ligj në ambiente pune dhe publike që në vitin 2007.

Në vitin 2010, duhan pirja përbën 22 përqind të të gjitha vdekjeve në Shqipëri. Në dy dekadat e fundit, gjatë tranzicionit të shpejtë politik dhe socio-ekonomik, shkalla e vdekshmërisë që i atribuohet duhan pirjes pothuajse është dyfishuar për sëmundje të pa transmetueshme (Instituti i Shëndetit Publik 2014).

Rezultate nga Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës tregojnë një diferencë të madhe në sjelljen e duhan pirjes ndërmjet meshkujve dhe femrave. Në vitin 2012, 16 përqind e meshkujve të moshuar raporton që pi duhan dhe vetëm 2 përqind e grave raporton që pi duhan. Për meshkujt, kjo përqindje është më pak se popullsia e meshkujve të rritur 30 deri në 64 vjeç (25 përqind) dhe rreth njësoj si për meshkujt e rinj (13 përqind). Gratë e moshuara, nga ana tjetër pinë duhan relativisht më shumë sesa femrat 30 deri në 64 vjeç dhe femrat e reja (të dyja rreth 1 përqind vetëm). Një vëzhgim interesant nga anketa të njëpasnjëshme të AMNJ tregon që duhan pirja mes të moshuarve duket se ulet, sidomos mes meshkujve: 33 përqind e të moshuarve meshkuj pinë duhan, duke u ulur në 21 përqind në vitin 2008. Përqindja e grave të moshuara që pinë duhan është ulur nga 4 përqind në vitin 2005 (Figura 4.2). Këto ndryshime mund të jenë tregues i ndikimit pozitiv të ndalimit të duhan pirjes.


Figura 4.2: Përqindja e të moshuarve 65 vjeç e lart që pi duhan, sipas vitit të anketës



Burimi: AMNJ 2005, 2008, 2012

AMNJ gjithashtu mbledh informacion për konsumin e alkoolit. Ashtu si me duhan pirjen, dallimet e mëdha gjinore janë vërejtur për përdorimin e alkoolit. Më shumë se tre të katërtat (77 përqind) e grave të moshuara raportojnë që nuk kanë përdorur alkool në muajt e kaluar, krahasuar me më pak se gjysmën (45 përqind) e meshkujve. Relativisht diferenca më e madhe është gjetur mes personave që pinë alkool rregullisht (të paktën 10 ditë në muaj përpara anketës) ose çdo ditë. Përqindja e meshkujve që pinë alkool rregullisht ose çdo ditë ka qenë përkatësisht 12 dhe 10 përqind, por përqindja e grave nuk është e lartë (1 përqind secila).

Figura 4.3: Të moshuarit 65 vjeç e lart sipas konsumit të alkoolit (në përqindje)



Burimi: AMNJ 2012

4.4 AFTËSIA E KUFIZUAR


Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011 përfshiu një grup pyetjesh për të vlerësuar statusin e aftësisë së kufizuar në popullsinë e Shqipërisë. Pyetjet bëhen sipas rekomandimeve të grupit të Uashingtonit duke pyetur për vështirësitë e përjetuara në veprimet bazë, që ngrenë pengesa për pjesëmarrjen e plotë në shoqëri. Pyetjet mbulojnë gjashtë veprime bazë ose fusha funksionale: shikimin, dëgjimin, ecjen, të kuptuarit, kujdesin për veten dhe komunikimin. Një person konsiderohet me aftësi të kufizuara nëse ai ose ajo ka probleme serioze për kryerjen e veprimtarive ose nëse ai/ajo nuk është aspak në gjendje që të kryejë ndonjë veprimtari.

Përafërsisht 73 mijë persona 65 vjeç e lart klasifikohen me aftësi të kufizuara sipas të dhënave të censurit 2011. Kjo shifër është më shumë se gjysma (53 përqind) e të gjithë personave me aftësi të kufizuara të moshës 15⁴ vjeç e lart, ndërsa popullsia e të moshuarve përfaqëson vetëm 14 përqind të të gjithë personave 15 vjeç e lart. Siç tregohet në Figurën 4.4, mundësia në rritje për aftësi të kufizuara vjen më rritjen e moshës. Kjo ndodh sepse ndërsa njerëzit jetojnë më gjatë dhe nuk përballen me sëmundje fatale, sëmundjet e tyre janë kronike. Ndërmjet një e pesta dhe një e treta e të moshuarve 65 vjeç e lart janë me aftësi të kufizuara: 20 përqind e meshkujve dhe 25 përqind e femrave. Mes më të moshuarve (80 vjeç e lart), 42 përqind janë me aftësi të kufizuara: 38 përqind e meshkujve dhe 44 përqind e femrave.

Gratë e moshuara kanë prirje më të lartë për aftësi të kufizuara sesa meshkujt e moshuar. Në një farë mase kjo është pasojë e shpërndarjes së moshës të vjetër të grave, por nuk mund të jetë shpjegim i plotë sepse edhe normat e aftësisë së kufizuar të femrave në moshë specifike janë vazhdimisht më të larta. Gjithashtu, rolet gjinore që përshkruajnë përgjegjësinë e grave për shumicën e detyrave shtëpiake mund të jenë faktor, për shkak se aftësia e kufizuar do të pengojë më rëndë funksionimin e femrave sesa të meshkujve në këtë drejtim.

4 Meqë raportimi për aftësi të kufizuara në moshë të re është i pabazueshëm, të dhënat e censurit raportojnë vetëm për personat 15 vjeç e lart.

Figura 4.4: Prevalenca e aftësisë së kufizuar sipas gjinisë dhe sipas moshës (në përqindje)




Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

Epërsia e aftësisë së kufizuar varion në fushat e funksionalitetit. Lloji më i zakonshëm i aftësisë së kufizuar mes të moshuarve është lëvizshmëria. Për 17 përqind të të moshuarve, censusi ka regjistruar që ka pasur vështirësi të mëdha në ecje ose ngjitjen e shkallëve (lëvizshmëria) (Figura 4.5). Për personat që jetojnë në zonat rurale, kjo mund të jetë veçanërisht problematike. Të pasurit e një problemi të madh me kujdesin për veten (kryerjen e veprimtarive të përditshme si bërja e pazarit, veshja, larja ose gatimi; 8 përqind e të moshuarve) është një tregues i qartë i pamundësisë për të jetuar në mënyrë të pavarur. Megjithatë, edhe lloje të tjera të aftësisë së kufizuar mund të krijojnë probleme të patejkalueshme në këtë drejtim. Krahasuar me popullsinë më të re, 15 deri në 64 vjeç, sidomos aftësitë e kufizuara të dëgjimit dhe shikimit, janë më të zakonshme mes të moshuarve.

Rreth gjysma (49 përqind) e personave të moshuar me aftësi të kufizuara ka vuajtur nga një lloj kufizimi, por gjysma tjetër - 37 mijë persona- ka vuajtur nga dy ose më shumë lloj kufizimesh, duke treguar që aftësitë e kufizuara të shumëfishta janë problem i zakonshëm mes popullsisë më të vjetër shqiptare. Një e pesta e personave me aftësi të kufizuara ka pasur katër ose më shumë kufizime të tilla. Epërsia e aftësive të kufizuara të shumëfishta është e njëjtë mes meshkujve dhe grave.

Figure 4.5: Prevalenca e aftësisë së kufizuar për lloje të ndryshme aftësish të kufizuara mes të moshuarve, sipas gjinisë (në përqindje)




Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

Pothuajse i njëjti numër i të moshuarve me aftësi të kufizuara ka jetuar në zona urbane dhe rurale, por norma e këtij kufizimi është e ndryshme sipas vendbanimit. Rreth 21 përqind e të moshuarve urban raporton se ka një ose më shumë probleme funksionale, krahasuar me 26 përqind të të moshuarve ruralë. Të dhënat e censusit nuk mund të përcaktojnë nëse shkaku i këtij dallimi është niveli më i lartë i pamundësisë dhe shëndetit të keq në zonat rurale apo ndikimi më i madh i aftësisë së kufizuar në kryerjen e veprimtarive specifike në jetën e përditshme rurale.

Një dallim edhe më i madh i aftësive të kufizuara është regjistruar në census ndërmjet të moshuarve të martuar dhe të moshuarve të pamartuar aktualisht (përfshirë personat që nuk janë martuar asnjëherë dhe të ve, të divorcuar dhe të ndarë). Më pak se një e pesta (19 përqind) e të moshuarve të martuar është thënë që janë me aftësi të kufizuara, krahasuar me përafërsisht një të tretën (31 përqind) e bashkëmoshatarëve të pamartuar. Grupi i fundit është në pozicion veçanërisht të rrezikuar, sepse pengesa e tyre funksionale është keqësuar nga mungesa e bashkëpunimit të një partneri. Grupi i personave të pamartuar aktualisht përfshin një numër të vogël personash- 5 mijë- që nuk janë martuar asnjëherë. Nisur nga parimi i martesës universale mes brezave më të vjetër në Shqipëri, ka shumë mundësi që këta persona të mos jenë martuar asnjëherë për shkak se kanë patur aftësi të kufizuara. Norma e lartë e aftësive të kufizuara të të moshuarve të ve është gjerësisht efekt i moshës si faktor bashkë-përcaktues: sa më të vjetër të jenë njerëzit, aq më e madhe është mundësia që do të bëhen të ve dhe ata do të kenë aftësi të kufizuara.

Niveli i arsimit të kryer nga të moshuarit me aftësi të kufizuara tregon qartë pozicionin e tyre të pa favorizuar krahasuar me të moshuarit të cilët nuk janë me aftësi të kufizuara. Rreth një e treta (31 përqind) e të moshuarve me aftësi të kufizuara nuk kanë përfunduar arsimin dhe 29 përqind nuk kanë ndjekur ndonjëherë shkollën (Figura 4.6). Shifrat përkatëse për të moshuarit pa aftësi të kufizuara janë 9 dhe 1 përqind. Në anën tjetër të peshores, përqindja me aftësi të kufizuara që ka përfunduar një nivel të arsimit dytësor (27 përqind) ka qenë rreth gjysma e asaj të bashkëmoshatarëve që nuk kanë aftësi të kufizuara (52 përqind). Për arsimin terciar të përfunduar, diferenca relative ka qenë edhe më e madhe: 3 përqind kundrejt 9 përqind përkatësisht.

Figura 4.6: Popullsia 45 vjeç e lart sipas statusit të aftësisë së kufizuar dhe nivelit arsimor (në përqindje)



Burimi: Censuri i Popullsisë dhe Banesave 2011



5 TË MOSHUARIT NË PUNË

5.1 HYRJE

Në statistikat zyrtare të Shqipërisë për punësimin, popullsia e të moshuarve nuk është e dukshme sepse mosha e punës është përcaktuar 15 deri në 64 vjeç. Megjithatë, në ekonomi që karakterizohet nga punësimi informal dhe sektor i madh bujqësor, shpesh njerëzit janë ekonomikisht aktivë në moshë të vjetër. Në një farë mase, kështu ndodh edhe në Shqipëri. Ky kapitull rishikon pjesëmarrjen në punë të popullsisë 65 vjeç e lart dhe krahason karakteristikat e atyre që punojnë me shumicën që është inaktive. Anketa e Forcës së Punës (AFP) është burimi kryesor i informacionit për këtë rishikim. Gjithashtu, përdoren të dhënat nga Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011. Meqë fundi i karrierës së punësimit lidhet shpesh me gëzimin e një pensioni të moshës së vjetër, seksioni 5.2 së pari shkurtimisht përshkruan karakteristikat kryesore të sistemit të pensioneve në Shqipëri.

5.2 SISTEMI I PENSIONEVE NË SHQIPËRI

Sistemi i sigurimeve shoqërore në Shqipëri përfshin tre komponentë: sigurimin shoqëror të detyruar, sigurimin shoqëror vullnetar dhe sigurimin shoqëror shtesë. Sistemi i pensioneve bazohet gjerësisht në parimin paguaj sot që të përfitosh nesër (pay as you go), pra pagesat e pensioneve që i bëhen pensionistëve merren nga personat që punojnë të cilët kontribuojnë në skemën e pensioneve dhe taksave. Njerëzit kanë të drejtë të marrin pension nëse marrin pjesë në skemën e sigurimit për pension gjatë viteve të punës. Me të paktën 35 vjet kontribut, paguhet pension i plotë, duke filluar nga mosha 65 për meshkuj dhe 60 vjeç për femrat. Pensioni i pjesshëm mund të fillojë disa vite më përpara. Në rast se pensioni që ka të drejtë për pension vdes, pensioni konvertohet në pension familjar për personat në varësi të tij, që mund të jenë fëmijë, bashkëshorti dhe bashkëshortja, ose prindërit.

Sistemi shqiptar i pensioneve përballet me sfida të mëdha që janë pjesërisht të brendshme në sistem dhe pjesërisht të nxitura nga zhvillime të jashtme. Me kalimin e kohës, norma e kontributit të detyruar për skemën e pensionit është ulur nga 42.5 në 24.5 përqind të pagës bruto, duke reduktuar direkt shumën e të ardhurave që janë futur në skemën e detyrueshme. Zhvillime të jashtme që sfidojnë qëndrueshmërinë e sistemit të pensioneve janë papunësia në rritje në Shqipëri dhe përqindja e madhe e punësimit informal nga i cili mbliidhen kontribute për pension të ulët. Por në këndvështrim afatgjatë sidomos moshimi i popullsisë është faktor që trondit sistemin aktual. Numri i personave që janë në moshë pensioni po rritet shpejt, ndërsa numri i atyre në moshë pune (15 deri në 64) do të ulet gradualisht. Kjo është përjetuar tashmë në dekadat e shkuara: raporti i varësisë të moshës së vjetër⁵ pothuajse është dyfishuar nga 8.6 përqind në vitin 1989 në 16.7 përqind në vitin 2011 (shihni seksionin 2.3.1 të këtij raporti). Në vitin 2030, ky raport do të dyfishohet përsëri në 32.9 përqind (INSTAT 2004). Ky zhvillim demografik nënkupton që parimi paguaj sot që të përfitosh nesër (pay as you go) nuk është i qëndrueshëm dhe duhet të zëvendësohet nga parimi i kontributit të përcaktuar (p.sh Creedy 1998, Bravi 1999***).

5.3 TË PUNUARIT DHE TË MOS PUNUARIT

Sipas APF 2011, numri i të moshuarve që punojnë llogaritet të jetë 33 mijë. Në gjithë popullsinë e punësuar prej 1.2 milion, kjo shifër është një pakicë e vogël prej 3 përqind. Megjithatë, kjo shifër sugjeron që 10 përqind e personave të moshës 65 vjeç e lart punon. Në këto mosha të vjetra, më shumë meshkuj sesa femra punojnë, përkatësisht 21 mijë dhe 12 mijë persona. Kjo përkthehet në një përqindje të atyre që punojnë e cila është dy herë më e lartë për meshkujt (14 përqind, rreth një në shtatë) se sa për gratë (7 përqind). Të dhënat për vitin 2014 tregojnë një numër disi më të ulët të të moshuarve që punojnë (31 mijë) dhe përqindja që punon (9 përqind), por këto dallime janë shumë të vogla për të nxjerrë një tendencë të rëndësishme statistikore.

Siç pritet, shumica e personave që nuk punojnë shprehen që janë inaktivë sepse kanë rritur moshën e pensionit dhe marrin një pension (97 përqind). Një tjetër arsye që është përmendur është aftësia e kufizuar. Edhe në këtë drejtim, shifrat për 2001 dhe 2014 janë shumë të ngjashme. Censusi i vitit 2011 gjen një përqindje shumë të ngjashme që ka raportuar

⁵ Raporti i varësisë së të rinjve është raporti i popullsisë të moshës 65 vjeç e lart me popullsinë e grupmoshës 15-64, i shprehur në përqindje.

se nuk punon për shkak të daljes në pension (95 përqind). Gjithashtu të dhënat e censurit lejojnë vlerësimin që kjo të zbatohet po aq për gratë sa edhe për burrat (94 dhe 96 përqind, përkatësisht).


5.4 KARAKTERISTIKAT E TË MOSHUARVE QË PUNOJNË

Klasifikimi i personave të punësuar sipas statusit në punësim jep të dhëna për llojin e riskut ekonomik me të cilin përballet i punësuar në punë, forcën e lidhjes institucionale ndërmjet personit dhe punës dhe llojin e autoritetit mbi institucionet dhe punëtorët e tjerë. Ekonomitë e avancuara synojnë të kenë përqindje të lartë të punëtorëve në punësim me pagë ose normë ndërsa ekonomitë informale dhe të nën-zhvilluara synojnë të kenë përqindje të madhe të punëtorëve për llogari të tyre. Rëndësia e punëtorëve që kontribuojnë në familje zakonisht tregon edhe zhvillimin e dobët, rritjen jo të madhe të punësimit, varfërinë e përhapur dhe shpesh një ekonomi gjerësisht rurale. Treguesi OZHM 1.7 për të matur progresin drejt punësimit të plotë dhe produktiv dhe punën e denjë për të gjithë (Objektivi 1.B) i grupon këto dy kategoritë e fundit për vlerësimin e përqindjes në "punësim të pambrojtur". Punëtorë për llogari të tyre dhe që kontribuojnë për familjen kanë mundësi më të pakta për të patur marrëveshje formale pune dhe prandaj ka më shumë të ngjarë që të mos i kenë elementët që lidhen me punësimin e denjë si për shembull sigurime të mjaftueshme shoqërore dhe një zë në punë.

Nisur nga fakti që të moshuarit kanë kaluar moshën e pensionit, duhet të pritët që shumica e atyre që kanë pasur punësim formal në të shkuarën të mos punojnë aktualisht dhe të moshuarit që mbeten janë mes punëtorëve për llogari të tyre dhe punëtorë që kontribuojnë në familje. Kjo në fakt është raportuar në Anketën e Forcës së Punës. Shumica dërmuese e 93 përqind të të moshuarve që punojnë kanë qenë në një nga dy llojet e punësimit të pambrojtur. 43 përqind si punëtorë për llogari të tyre dhe 51 përqind si punëtorë që kontribuojnë në familje. Shpërndarja është e ndryshme për meshkuj dhe për femrat. Rreth tre të katërtat e grave janë punëtore që kontribuojnë në familje - shpesh punojnë tokën bujqësore të bashkëshortëve ose djemve të tyre - ndërsa meshkujt klasifikohen më shpesh si punëtorë për llogari të tyre, shpesh duke punuar tokat e tyre me ose pa mbështetje nga familjarët e tjerë.

Sektori ekonomik ku shumica e të moshuarve janë aktivë është bujqësia. Rreth 84 përqind e tyre punojnë në këtë sektor, i cili është dyfish përqindja e popullsisë në moshë pune 15 deri në 64 vjeç (42 përqind). Gratë e moshuara që punojnë janë akoma më shumë të përqendruara në bujqësi (92 përqind; Figura 5.1), ndërsa meshkujt e moshuar zënë një përqindje të identifikueshme (14 përqind) në shërbimet e tregut. Profesione të tilla që kanë të moshuarit pasqyrojnë sektorin e industrisë, në kuptimin që përqindje të ngjashme punojnë si fermerë.

Figure 5.1: Popullsia e moshuarve 65 vjeç e lart që punon, sipas gjinisë dhe sektorit të punës (në përqindje)



Burimi: Anketa e Forcës së Punës 2011

Krahasuar me popullsinë në moshë pune, të moshuarit punojnë më pak orë. Më pak se gjysma (47 përqind) e të moshuarve që punojnë punojnë më pak se 30 orë në javë, krahasuar me 21 përqind të grupmoshës 15-64 vjeç. Megjithatë, më shumë se një e treta (përqind) e të moshuarve punon 40 orë ose më shumë, gjë kjo që është barrë e rëndë në moshë të vjetër. Meshkujt e moshuar kanë prirje të punojnë më shumë orë sesa gratë. Rreth 42 përqind e tyre kanë punuar 40 orë ose më shumë në javë, kundrejt 25 përqind të grave. Nga ana tjetër, vetëm 40 përqind kanë punuar më pak se 30 orë, krahasuar me 61 përqind të grave.

6

MOSHIMI AKTIV DHE VULNERABILITETI

6.1 HYRJE

Qëllimi i këtij kapitulli është të bëjë një vlerësim të përgjithshëm të situatës së të moshuarve në Shqipëri. Njëri konsiderohet nga perspektiva e potencialit të personave të moshuar për të marrë pjesë aktive në shoqëri (seksioni 6.2). Kjo është në përputhje me Planin e Veprimit të Asamblesë së Dytë botërore për Moshimin i cili synon të arrijë moshim të sigurt dhe pa varfëri, duke marrë pjesë në jetën ekonomike, politike dhe sociale dhe duke pasur mundësi për t'u zhvilluar më vonë. I dyti (seksioni 6.3) është tregues i vulnerabilitetit të të moshuarve në Shqipëri. Të dyja masat kombinojnë informacionin në kapitujt e mëparshëm tematikë me informacionin nga burime shtesë.

6.2 MOSHIMI AKTIV

Moshimi aktiv është procesi i maksimizimit të mundësive për shëndet, pjesëmarrje dhe siguri për të rritur cilësinë e jetës me moshimin e tyre. Ai lejon njerëzit që të realizojnë potencialin e tyre për mirëqenie fizike, sociale dhe mendore, gjatë gjithë jetës së tyre dhe të marrin pjesë në shoqëri, ndërsa i ofron atyre mbrojtje të mjaftueshme, siguri dhe kujdes kur kanë nevojë. Fjala "aktiv" i referohet pjesëmarrjes së vazhdueshme në çështje sociale, ekonomike, kulturore, shpirtërore dhe qytetare, jo vetëm aftësisë për të qenë fizikisht aktiv apo për të marrë pjesë në forcën e punës. Të vjetrit që dalin në pension nga puna dhe ata që janë të sëmurë ose jetojnë me aftësi të kufizuara mund të mbeten kontribues aktiv për familjet, bashkëmoshatarët, komunitetet dhe kombet e tyre. Moshimi aktiv synon të shtrijë jetëgjatësinë e shëndetshme dhe cilësinë e jetës për të gjithë personat ndërsa plaken, përfshirë ata që janë të dobët, me aftësi të kufizuara dhe në nevojë për kujdes.

Në kuadër të Vitit European 2012 për Moshimin Aktiv dhe Solidaritetin ndërmjet Brezave, është zhvilluar Indeksi i Moshimit Aktiv (IMA) si një mekanizëm për politikbërësit kombëtarë dhe europianë që të masin dhe promovojnë potencialin e popullsisë më të vjetër.⁶ Ky indeks është ndërtuar nga 22 tregues të veçantë që grupohen në katër fusha:

1. Punësimi i punëtorëve të më të vjetër;
2. Veprimtaria sociale dhe pjesëmarrja e personave më të vjetër;
3. Jetesa e pavarur dhe autonome e personave më të vjetër; dhe
4. Aftësia dhe mjedisi mundësues për moshim aktiv.


Rezultatet e IMA mund të përdoren për të krahasuar situatën në vendet Europiane me IMA të përgjithshëm dhe indicet specifike të fushës. Fatkeqësisht, IMA nuk është llogaritur akoma për Shqipërinë. Si alternativë, për Shqipërinë Indeksi Global i Mbikëqyrjes së Moshës⁷ është ndërtuar për cilësinë e jetës në moshë më të mëdha dhe mirëqenien e personave më të vjetër. Indeksi mbledh në tërësi 13 tregues të krahasueshëm në nivel ndërkombëtar, bazuar në statusin e të ardhurave të personave të vjetër, statusin shëndetësor, aftësinë (arsimi dhe punësimi) dhe mjedisin mundësues. Indeksi bazuar në këto katër fusha (shihni Aneksin II) supozohet që jep një tregues të qartë sa mirë ia dalin popullsitë e moshuara në vende të ndryshme. Indeksi aktualisht është llogaritur për 96 vende, duke mbuluar 91 përqind të popullsisë së botës 60 vjeç e lart. Shqipëria është një nga 96 vendet për të cilat është llogaritur ky tregues.

Indeksi Global i Mbikëqyrjes së Moshës ka vendosur Shqipërinë në vendin e 53-të në botë. Renditet më lart në fushën e aftësive (24) me një nga normat më të larta të punësimit në rajon (58 përqind) (Figura 6.1). Ka një performancë mesatare në fushën e sigurisë së të ardhurave (45) me një mesatare nën nivelin e varfërisë në moshën e vjetër (5.3 përqind), e dyta më e ulëta në rajon, dhe mbulimin e skemës së pensioneve mbi mesataren globale (77 përqind),

⁶ <http://www1.unece.org/stat/platform/display/AAI/Active+Ageing+Index+Home>
⁷ Përgatitur nga HelpAge International (<http://www.helpage.org/global-agewatch/>)


pavarësisht GNI në nivelin mesatar për frymë. Renditet poshtë në fushën e shëndetit (61) me vlera nën mesatare për jetëgjatësinë, por mbi mesataren për treguesin e mirëqenies psikologjike në nivel rajonal. Renditet më poshtë në fushën e mjedisit mundësues (86), si në vitin 2014 me vlera rajonale nën mesatare për të katër treguesit në këtë fushë (lidhjet sociale, siguria fizike, liria qytetare dhe aksesit në transportin publik).

Figura 6.1: Indeksi global i mbikëqyrjes së moshës Shqipëria 2014 (renditja)




Burimi: AgeWatch report card

Treguesit e përbërë në themel të katër fushave të përmendura në figurën 6.1 janë paraqitur në Figurën 6.2. Përkuftizimet e këtyre treguesve jepen në Aneksin I. Indeksi i përgjithshëm 53 e rendit Shqipërinë përpara vendeve fqinjë si Kroacia, Serbia dhe Maqedonia (Figura 6.3). Katër fushat për Indeksin Global të Mbikëqyrjes së Moshës janë të veçanta sipas vendit në Figurën 6.4.


Figura 6.2: Treguesit global të mbikëqyrjes së moshës Shqipëria 2014

Burimi: AgeWatch report card

Figura 6.3: Indeksi i përgjithshëm global i mbikëqyrjes së moshës, sipas vendit të përzgjedhur (2014)

Burimi: AgeWatch report card

Figura 6.4: Treguesit globalë të mbikëqyrjes së moshës sipas vendit të përzgjedhur dhe sipas fushës (2014)



Burimi: AgeWatch report card

6.3 INDEKSI I VULNERABILITETIT TË TË MOSHUARVE

Duke kombinuar disa pyetje të pyetësorit të Censurit 2011, si pyetjet për karakteristikat individuale dhe të njësive ekonomike familjare, është e mundur që të llogaritet një tregues që mat nivelin e vulnerabilitetit të personave 65 vjeç e lart. Qëllimi i këtij treguesi është të japë informacion për nivelin e vulnerabilitetit të të moshuarve në 61 bashki, sipas ndarjes së re administrative. Kjo do të ndihmojë politikë bërësit që të identifikojnë më mirë politikat përkatëse dhe programet për të ndihmuar të moshuarit vulnerabël. Aktualisht, është e detyrueshme që të jepen të dhëna për të treguar se si të moshuarit vulnerabël mund të mbështeten nga politikat dhe programet publike.

Kjo qasje përcakton vulnerabilitetin si një koncept dinamik duke ju referuar rrezikut që do të përjetojë një i moshuar:

1. që jeton vetë, ose
2. që jeton në shtëpi pleqsh, ose
3. që ka të paktën një aftësi të kufizuar (dëgjimin, shikimin ose lëvizjen), ose
4. që ka burim të ardhurash ndihmën sociale, remitancat ose të ardhura të një personi tjetër.

Edhe pse mund të ketë masa të ndryshme të vulnerabilitetit, në këtë rast specifik, masa e vulnerabilitetit të të moshuarve (65 vjeç e lart) merr parasysh katër komponentë. Komponenti i parë trajton të moshuarit që jetojnë vetë dhe prandaj mendohet se janë vulnerabël. Komponenti i dytë trajton të moshuarit që jetojnë në shtëpi pleqsh. Komponenti i tretë trajton të moshuarit me aftësi të kufizuara, ku secili nga kufizimet, dëgjimi, shikimi dhe lëvizja, zë një të tretën. Komponenti i katërt mat burimin e të ardhurave ose mungesën e tyre përfshirë të ardhurat nga ndihma sociale, remitancat dhe persona të tjerë.


Teorikisht, vlerat e indeksit variojnë nga 0.33 (nëse secili person plotëson një nga kushtet e mësipërme) në 4. Në Shqipëri, indeksi mesatar i vulnerabilitetit të personave 65 vjeç e lart është 1.14. Vlera maksimale e tij vërehet në bashkinë e Kukësit (1.34), ndërsa vlera minimale në bashkinë e Finiqit (0.99). Nga 61 bashki, 35 prej tyre kanë indeks vulnerabiliteti më të lartë se mesatarja e vendit (1.14).

Për të dhënë një pamje më të plotë të vendndodhjes së të moshuarve vulnerabël, ky indeks është paraqitur në Figurën 6.5. Harta është ndërtuar në nivel të 61 bashkive për të dhënë një pamje të vulnerabilitetit të të moshuarve në vend. Kjo hartë mund të ndihmojë planifikuesit socialë në ofrimin e shërbimeve sociale bazuar në nevojat dhe vendndodhjen e grupeve të të moshuarve vulnerabël.

Indeksi i vulnerabilitetit të të moshuarve tregon që nivelet më të larta janë përqendruar në veri-lindje të Shqipërisë,

edhe pse vulnerabiliteti është i përhapur gjerësisht në të gjithë vendin. Megjithatë, Hasi, Kukësi, Dibra, Bulqiza, Klosi, Mati dhe Puka në pjesën veri-lindore të vendit mbeten bashkitë më nivelet më të larta të vulnerabilitetit. Kjo mund të lidhet me numrin e lartë të popullsisë së të rinjve që janë larguar nga këto zona në zonat urbane duke lënë kështu pas të moshuarit. Zonat malore njihen për përqendrimin e popullsisë vulnerabël më të vjetra që nuk mund të largohen dhe janë zënë ngushtë në kurthin e varfërisë.

Figura 6.5: Indeksi i vulnerabilitetit të të moshuarve 65 vjeç e lart, sipas bashkisë



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011



7

PËRMBLEDHJE

7.1 HYRJE

Shqipëria ka filluar të përjetojë pasojat e procesit të moshimit të popullsisë që ka filluar tashmë prej disa dekadash në shumicën e vendeve të tjera europiane. Këto pasoja nuk maten vetëm me numrin në rritje të të moshuarve - të përkufizuar si persona 65 vjeç e lart - por edhe në lidhje me mundësitë e reja dhe sfidat për vetë të moshuarit dhe për mbarë shoqërinë.

Zhvillimet drejt një shoqërie më të pasur, jetëgjatësisë në rritje dhe arsimit të zgjeruar kanë ndryshuar ndjeshëm - dhe do të ndryshojnë - rolet dhe kushtet e jetesës së të moshuarve. Panorama e përgjithshme që tregohet nga kjo analizë është që brenda një procesi të përgjithshëm të rënies së popullsisë, të moshuarit janë segmenti i vetëm që po rritet fuqishëm dhe që mund të përfaqësojë një të tretën e të gjithë popullsisë në vitin 2031. Ka mundësi që në dekadat e ardhshme, popullsia e të moshuarve nuk do të tregojë vetëm një prani të rëndësishme demografike, por gjithashtu do të bëhet një forcë e rëndësishme ekonomike dhe politike. Edhe pse përgjithësisht kushtet e jetesës së të moshuarve shqiptarë mbeten pas nga ato të bashkëmoshatarëve të tyre europianë, përmirësime të mëdha janë vënë re në krahasim me situatën e vërejtur edhe në të shkuarën e afërt.

Njëkohësisht, procesi i moshimit do të vendosë një barrë të rëndë mbi sistemet ekzistuese të pensionit dhe kujdesit shëndetësor. Meqë njerëzit jetojnë më gjatë, përfitime si pensioni, kujdesi shëndetësor ose mbështetja për moshën e vjetër, duhet të paguhet gjatë periudhave më të mëdha. Kur popullsia përtej moshës së pensionit dyfishohet dhe njëkohësisht popullsia në moshë pune që ofron fonde për sistemin e sigurimeve shoqërore bie, sistemi bëhet i paqëndrueshëm dhe ka nevojë për transformime strukturore. Jetëgjatësia në rritje gjithashtu rezulton në kosto mjekësore në rritje dhe kërkesa në rritje për shërbime shëndetësore, sepse të moshuarit janë më të rrezikuar ndaj sëmundjeve kronike. Po kështu, zhvendosja drejt një popullsie më të moshuar sjell një sërë ndryshimesh në shoqëri, si të ardhura më të ulëta, modele të ndryshme konsumi dhe kërkesa strehimi, dhe kërkesa të tjera politike dhe modele sëmundshmërie.

Procesi demografik i moshimit të popullsisë paraqet një detyrë të madhe për politikë bërësit dhe organizatat e shoqërisë civile që të trajtojnë këto çështje dhe të krijojnë mundësi për përqindjen në rritje të të moshuarve që të marrin pjesë në shoqërinë e të sotshme dhe të të nesërme në mënyrë aktive dhe produktive. Gjithashtu, politikat dhe programet duhet të kenë në vëmendje grupe specifike vulnerabel mes të moshuarve, si për shembull personat e ve/vejusha, personat me aftësi të kufizuara, kushtet e këqija të strehimit dhe mungesën e mbështetjes familjare dhe mjeteve të qëndrueshme financiare.

Ky raport bazohet në burime të ndryshme informacioni. Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011 përbën shtyllën e analizës. Të dhënat administrative dhe anketime të ndryshme janë plotësues dhe që japin më shumë detaje për informacionin e censurit. Për tema të ndryshme, informacioni i saktë i përditësuar është i pakët. Kjo ndihet veçanërisht në fushën e shëndetit dhe pjesëmarrjes në shoqëri.

7.2 TË MOSHUARIT, BREZI I SË ARDHMES

Shqipëria ka përfunduar tranzicionin e parë demografik dhe ka hyrë në fazë me lindshmëri nën nivelin e zëvendësimit dhe jetëgjatësi që afrohet me nivelin e shumë vendeve të tjera europiane. Zëvendësimi i gjeneratave të vogla të të moshuarve me gjenerata më të mëdha që kanë lindur më vonë është një faktor i rritjes së vërejtur të numrit të personave në moshën 65 vjeç e lart. Një tjetër faktor është rritja e jetëgjatësisë. Si pasojë, censusi i vitit 2011 tregon që numri i të moshuarve pothuajse është dyfishuar që në 1989 nga 169 në 318 mijë, ndërsa e gjithë popullsia ka rënë më 12 përqind në të njëjtën periudhë sidomos për shkak të rënies së madhe të numrit të fëmijëve dhe të të rinjve të rritur (me 45 dhe 24 përqind përafërsisht).

Këto ndryshime tregojnë një transformim të plotë të shoqërisë në një periudhë kohore prej vetëm 22 vjet. Ndërsa të moshuarit përbëjnë 5 përqind të popullsisë në vitin 1989, ata në vitin 2011 përfaqësonin 11 përqind, ndërsa përqindja e fëmijëve nën 15 vjeç ra nga 33 në 21 përqind. Ky transformim ka implikime të rëndësishme për qëndrueshmërinë e sistemit të pensione dhe për shërbimet shëndetësore dhe kujdesin për moshën e tretë, që përdoren gjerësisht nga të moshuarit. Një masë e barrës shoqërore të rritjes së të rinjve krahasuar me popullsinë në moshë pune paraqitet nga raporti i varësisë së të moshuarve, i cili u zhvillua nga 9 përqind në vitin 1989 në 17 përqind në vitin 2011. Për shkak të ndryshimeve në lindshmëri dhe migracionin dalës, ky tregues tregon dallime të mëdha në vend, nga 12 përqind në Kukës në 24 përqind në Gjirokastrë.

Procesi i moshimit do të vazhdojë për disa dekada të tjera. Numri i të moshuarve pritet që të arrijë 591 mijë në vitin 2031 duke përfaqësuar 33 të gjithë popullsisë. Brenda popullsisë së të moshuarve, të vjetrit më të moshuar-personat 80 vjeç e lart- janë përsëri segmenti me rritjen më të shpejtë. Përqindja e tyre në të gjithë popullsinë është rritur nga 0.9 përqind në vitin 1989 në 2.1 përqind në vitin 2011 (58 mijë persona) dhe pritet që të jetë madje 4.6 përqind në vitin 2031. Rritja e ardhshme në raportin e varësisë së të moshuarve tregon një dyfishim nga 17 përqind në vitin 2011 në 34 përqind në vitin 2031.

Analiza demografike tregon që në dekadën e shkuar, jetëgjatësia në lindje e popullsisë së Shqipëri është rritur disi nga 74.4 në vitin 2004 në 78.4 në vitin 2014. Gratë jetojnë mesatarisht 3.9 vjet më gjatë se burrat (80.3 kundrejt 76.4). Në fillim të periudhës së moshës së vjetër, në moshën 65 vjeç gratë pritet të jetojnë edhe 17.2 vjet dhe burrat edhe 15.9 vjet. Në moshën 80 vjeç, jetëgjatësia që mbetet është 7.0 dhe 6.5 vjet. Vdekshmëria më e madhe e meshkujve gjatë jetës do të thotë që femrat janë më të shumta në numër sesa meshkujt në moshë më të vjetër dhe diferenca është mjaft e gjerë mes të vjetërve më të moshuarve. Mes të gjithë të moshuarve 65 vjeç e lart, ka 91 meshkujt për çdo 100 femra në vitin 2011 dhe për të vjetrit më të moshuar 80 vjeç e lart ka vetëm 66 meshkujt për çdo 100 femra.

7.3 MOSHA DHE SHËNDETI I MIRË: SHOKË TË VËSHTIRË

Populli shqiptar jeton më gjatë se në të shkuarën; të jetuarit në shëndet të mirë po rriten me ritëm më të ngadaltë. Sëmundjet kronike ndikojnë në mënyrë jo proporcionale të rriturit e moshuar dhe lidhen me aftësitë e kufizuara, cilësinë e ulur të jetës dhe kostot e rritura për kujdesin shëndetësor dhe kujdesin afatgjatë. Rrjedhimisht, shëndeti do të bëhet një çështje politikash gjithnjë e më shumë e rëndësishme.

Në një anketim të kryer në 2007-08, 32 përqind e të moshuarve vlerësojnë veten të pashëndetshëm dhe 10 përqind me shëndet të keq. Përqindja e të gjithë të pyeturve që raporton se vuan nga një sëmundje kronike ka qenë 77 përqind. Rreth gjysma e të moshuarve raportojnë sëmundje kardiovaskulare dhe 19 përqind raportojnë diabetin. Më shumë se një në katër persona raporton që nuk ka marrë kujdes mjekësor ku ka pasur nevojë, shpesh për arsye financiare.

Sipas të dhënave të censusit 2011, rreth 73 mijë persona 65 vjeç e lart mund të klasifikohen me aftësi të kufizuara. Kjo shifër është më shumë se gjysma e të gjithë personave 15 vjeç e lart me aftësi të kufizuara në vend. Përqindja me aftësi të kufizuara mes meshkujve të moshuar ka qenë 20 përqind dhe mes femrave 25 përqind. Efekti i moshimit duket qartë në epërsinë më të madhe të aftësive të kufizuara mes të vjetërve më të moshuar, ku edhe 42 janë me aftësi të kufizuara: 38 përqind e meshkujve dhe 44 përqind e femrave. Lloji më i zakonshëm i aftësisë së kufizuar mes të moshuarve është lëvizja. Për 17 përqind të të moshuarve, censusi ka regjistruar që ka pasur vështirësi të mëdha në ecje ose ngjitjen e shkallëve. Gjysma e popullsisë së të moshuarve është me aftësi të kufizuara - 37 mijë persona- vuan nga dy ose më shumë kufizime.

Pothuajse i njëjti numër i të moshuarve me aftësi të kufizuara ka jetuar në zona urbane dhe rurale, por norma e këtij kufizimi është e ndryshme sipas vendbanimit. Rreth 21 përqind e të moshuarve urban raporton se ka një ose më shumë probleme funksionale, krahasuar me 26 përqind të të moshuarve ruralë. Të dhënat e censusit nuk mund të përcaktojnë nëse shkaku i këtij dallimi është niveli më i lartë i pamundësisë dhe shëndetit të keq në zonat rurale apo ndikimi më i madh i aftësisë së kufizuar në kryerjen e veprimtarive specifike në jetën e përditshme rurale. Megjithatë, dallimi sipas vendbanimit duket se kërkon vëmendje nga perspektiva e programeve dhe politikave për aftësitë e kufizuara. Një tjetër grup me aftësi të kufizuara janë të moshuarit pa bashkëshort/t: më pak se një e pesta (19 përqind) e të moshuarve të martuar është thënë që janë me aftësi të kufizuara, krahasuar me përafërsisht një të tretën (31 përqind) e bashkëmoshatarëve të pamartuar. Grupi i fundit është në pozicion veçanërisht të rrezikuar, sepse pengesa e tyre funksionale është keqësuar nga mungesa e bashkëpunimit të një partneri.

7.4 TË JETUARIT VETËM OSE SË BASHKU?

Normalisht të gjithë të moshuarit janë martuar ndonjëherë, me përjashtim të personave me aftësi të kufizuara të rënda. Gjendja civile në moshë të vjetër ndryshon shumë mes burrave dhe grave. Dallimi gjinor në vdekshmëri, i kombinuar me dallim moshe ndërmjet burrave dhe grave në kohën që lidhin martesë tregon që shumica (87 përqind) e meshkujve të moshuar janë akoma të martuar, ndërsa përfaqësisht vetëm gjysma e grave janë akoma në martesë dhe gjysma tjetër (48 përqind) kanë mbetur veçjusha. Rrjedhimisht, janë veçanërisht gratë e moshuara në Shqipëri ato që mbeten pa mbështetje praktike dhe emocionale që zakonisht ofrohet nga lidhja në martesë.

Personat më të vjetër që jetojnë vetë ose edhe vetë si çift rrezikojnë më shumë të përfuturin izolim social dhe deprivim ekonomik dhe prandaj mund të kërkojnë mbështetje të veçantë. Kombinimi i numrit më të vogël të fëmijëve, një stok më të madh strehimi dhe epërsia në rritje për pavarësi ka si pasojë që mesatarisht të moshuarit sot jetojnë në njësi ekonomike familjare më të vogla se në dekadat e shkuara. Përqindja e të moshuarve që jetojnë në njësi ekonomike familjare me shumë familje ka rënë nga 30 përqind në vitin 2001 në 19 përqind në vitin 2011 dhe përqindja që jeton si çift pa fëmijë është rritur nga 24 në 32 në të njëjtën dekadë ndërmjet censuseve. Implikimi i këtyre tendencave është që relativisht më pak të moshuar mbështeten nga anëtarët e familjes. Rreth 30 përqind jetojnë në njësi ekonomike familjare me dy persona zakonisht me bashkëshortin/bashkëshorten e moshuar dhe 8 përqind madje jeton vetëm; kështu këta persona bëhen vulnerabël. Shumica prej 77 përqind e të moshuarve që jetojnë vetëm janë gra.

7.5 DHE SI JANË KUSHTET E STREHIMIT?

Për standardet europiane, kushtet e strehimit të të moshuarve në Shqipëri janë të varfra dhe nga perspektiva e shëndetit publik, kërkojnë përmirësime në disa aspekte. Megjithatë, rezultatet e dy censuseve të fundit tregojnë përmirësime mjaft të shpejta. Në vitin 2001, 17 përqind e të moshuarve jetonin në banesa të mbipopulluara, por kjo përqindje u ul në 5 në vitin 2011. Rreth dy të tretat (65 përqind) ka pasur akses në ujë tubacioni në banesë në vitin 2011 krahasuar me 47 përqind përpara 10 viteve. Shifrat përkatëse për akses në ujë të rrjedhshëm tualeti në banesë janë 76 dhe 55 përqind. Rreth 7 përqind nuk kanë pasur akses në tualet me ujë të rrjedhshëm, duke u ulur në 31 përqind në vitin 2001. Shumica dërrmuese e të moshuarve - të paktën 72 përqind - përdor llojet e ngrohjes të banesës që mund të kontribuojnë në probleme shëndetësore dhe ndryshimin global të klimës.

7.6 MIRËQENIA MATERIALE

Shumica e atyre që punojnë të cilët kanë arritur moshën e pensionit tërhiqen nga tregu i punës. Megjithatë, 10 përqind e personave 65 vjeç janë akoma të përfshirë në punë. Edhe pse disa prej tyre mund të punojnë nga dëshira për të qenë aktivë, shumë të tjerë janë të detyruar të punojnë nga pamjaftueshmëria ose mungesa e pagesës së pensionit. Shumica e të moshuarve që punojnë (93 përqind) kanë qenë në punësim vulnerabël, shpesh kanë punuar tokat e tyre me ose pa mbështetje nga familjarët e tyre. Po kështu, 10 përqind e popullsisë 65 vjeç e lart ka nivel konsumi që është nën linjën e varfërisë. Këto shifra konfirmojnë panoramën që një përqindje e vazhdueshme të popullsisë së të moshuarve është në pozitë vulnerabël dhe nuk mund të plotësojë standardet bazë të jetesës.

Në masën që pajisjet shtëpiake japin një panoramë të besueshme të mirëqenies materiale, të dhënat e censusit të vitit 2011 tregojnë që përveç pajisjeve bazë si makina larëse, frigoriferi dhe TV, vetëm pas njësi ekonomike familjare me të moshuar mund të konsiderohen diku afër të qenit të pasura. Megjithatë, krahasuar me vitin 2001, përqindja e atyre që kanë mjete luksi si makina, mikrovalë dhe kondicionerë - edhe pse akoma shumë e ulët - është rritur ndjeshëm. Në lidhje me aksesin në mjete moderne të komunikimit, vetëm 15 përqind e të moshuarve kanë kompjuter dhe vetëm 9 përqind kanë lidhje interneti në shtëpitë e tyre. Nga ana tjetër 83 përqind e tyre kanë telefon celular.



ANEKSI I

Koncepte dhe përkufizime

Akses në transportin publik. Përqindja e personave mbi 50 që përdorin sistemet e transportit publik lokal.

Moshimi. Moshimi i popullsisë është procesi sipas të cilit individët më të moshuar zënë një përqindje më të madhe në raport me gjithë popullsinë.

Liria qytetare. Përqindja e personave mbi 50 që kanë lirinë e zgjedhjes në jetën e tyre.

Punëtorë kontribuues në familje. Ata punëtorë që janë të vetë-punësuar në një aktivitet të orientuar nga tregu të ngritur nga një person i afërm që jeton në të njëjtën njësi ekonomike familjare, i cili nuk mund të konsiderohet partner, sepse shkalla e tyre e angazhimit në funksionimin e aktivitetit, sa i përket kohës së punës ose faktorëve të tjerë që duhet të përcaktohen nga rrethanat kombëtare, nuk është në nivel të krahasueshëm me atë të drejtuesit të aktivitetit.

Arritje arsimore. Përqindja e popullsisë 60 vjeç e lart me arsim të mesëm ose të lartë. Arsimi është akumulimi i aftësive dhe kompetencave gjatë gjithë jetës që tregon potencial kapital social dhe njerëzor mes të moshuarve.

Të moshuar. Popullsia e grupmoshës 65 vjeç e lart.

Të punësuar. Të gjithë personat 14 vjeç e lart të cilët gjatë periudhës së referencës prej një jave, kanë qenë të përfshirë në punësim me pagesë ose vetë-punësim dhe që kanë punuar të paktën tetë orë. Të punësuarit përfshijnë ushtarakët dhe fillestarët, si edhe personat që kanë munguar përkohësisht në punë për shkak të pushimeve, lejes, shkurtimeve të përkohshme, ose që kanë pasur një detyrë të përcaktuar nga të pasurit e aksesit në toka të punuara bujqësore.

Punësimi i të moshuarve. Përqindja e popullsisë 55-64 vjeç që është e punësuar. Ky tregues mat aksesin e të moshuarve në tregun e punës dhe aftësinë e tyre për të plotësuar të ardhurat e pensionit me paga dhe aksesin e tyre në rrjete punësimi. Norma e punësimit është tregues për fuqizimin ekonomik të personave më të vjetër.

Indeksi i varfërisë. Përqindja e popullsisë me shpenzime mujore për konsum për frymë nën linjën e varfërisë.

Jetëgjatësia e shëndetshme në moshën 60 vjeç. Numri mesatar i viteve që një person 60 vjeçar mund të jetojë me shëndet të plotë.

Njësi ekonomike familjare. Një grup personash, të lidhur ose të palidhur mes tyre, që jetojnë së bashku si një njësi e vetme ekonomike familjare, pra ndajnë ose mbahen me një buxhet të përbashkët. Ata jetojnë së bashku, bashkojnë të ardhurat dhe konsumojnë të paktën një vakt së bashku çdo ditë.

Popullsi inaktive ose persona që nuk janë në forcën e punës. Të gjithë personat 14 vjeç e lart që nuk janë punësuar ose që janë të papunë gjatë periudhës së referencës prej një jave për shkak të (a) ndjekjes së institucioneve arsimore, (b) angazhimit në detyra shtëpiake, (c) daljes në pension ose moshës së vjetër, (d) aftësive të kufizuara ose (e) arsyeve të tjera që mund të specifikohen.

Jetëgjatësia. Jetëgjatësia në moshë specifike është numri mesatar i viteve shtesë që një person i kësaj moshe pritët të jetojë nëse niveli aktual i vdekshmërisë i vëzhguar për moshat mbi atë moshë do të vazhdonte për pjesën tjetër të jetës së atij personi. Në veçanti, jetëgjatësia në lindje është numri mesatar i viteve që një i porsalindur do të jetojë nëse norma aktuale e vdekshmërisë specifike do të vazhdonte.

Mosha medianë. Mosha që ndan një popullsi në dy grupe me madhësi të njëjtë, në mënyrë të tillë që gjysma e të gjithë popullsisë të jetë më e re se kjo moshë dhe gjysma tjetër më e vjetër.

Raporti i varësisë së të moshuarve. Raporti ndërmjet numrit të të moshuarve nën 15 vjeç me numrin e personave në moshë më produktive të grupmoshës 15-64, i shprehur në përqindje.

Norma e varfërisë të të moshuarve. Përqindja e personave 60 vjeç e lart me të ardhura më pak se gjysma e të ardhurave medianë të vendit.

I moshuari më i vjetër. Popullsia e grupmoshës 80 vjeç e lart.

Punëtor për llogari të vet. Ata punëtorë që punojnë për llogari të tyre ose me një ose më shumë partnerë kanë llojin e punës të përkufizuar si vetëpunësim dhe nuk kanë përfshirë vazhdimisht punëtorë që të punojnë për ata gjatë periudhës së referencës.

Mbulimi me pension. Përqindja e popullsisë mbi 65 vjeç që merr pension.

Siguria fizike. Përqindja e personave mbi 50 vjeç që ndihen të sigurt kur ecin vetë gjatë natës në qytet ose në zonën e banimit të tyre.

Hendeku i varfërisë. Distanca mesatare ndërmjet niveleve të konsumit të të varfërve dhe linjës së varfërisë.

Mirëqenia relative mendore/psikologjike. Përqindja e personave mbi 50 vjeç që ndiejnë se jeta e tyre ka kuptim krahasuar me personat 35-49 që ndihen njësoj.

Mirëqenia relative. Të ardhura mesatare/konsum i personave 60 vjeç e lart si përqindje e të ardhurave mesatare/konsumit të pjesës tjetër të popullsisë.

Raporti gjinor. Numri i meshkujve për njëqind femra në popullsi.

Lidhjet sociale. Përqindja e personave mbi 50 vjeç që kanë të afërm ose miq tek të cilët mund të mbështeten kur janë në telashe.

Indeksi Sintetik i Fekonditetit (ISF). Numri mesatar i fëmijëve që mund të lindë një grua gjatë jetës së saj nëse norma specifike aktuale e lindshmërisë mbetet konstante gjatë viteve të saj të lindjes së fëmijëve (normalisht ndërmjet moshës 15 dhe 49 vjeç). Indeksi sintetik aktual i fekonditetit është tregues i nivelit të lindshmërisë në një kohë të caktuar.

ANEKSI II

Përbërja e Indeksit Global të Mbikëqyrjes së Moshës

Indeksi Global i Mbikëqyrjes së Moshës

Fushat	Siguria e të ardhurave	Statusi shëndetësor	Mundësitë	Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm
Indikatorët	Mbulimi nga të ardhurat e pensioneve	Jetëgjatësia në moshën 60	Punësimi i të moshuarve	Lidhjet sociale
	Norma e varfërisë së të moshuarve	Jetëgjatësia me shëndet të mirë në moshën 60	Statusi në arsim	Siguria fizike
	Mirëqenia relative	Mirëqenia psikologjike		Liria qytetare
	PKB për frymë			Aksesi në transportin publik

Fusha 1: Siguria e të ardhurave

Fusha e sigurisë së të ardhurave vlerëson aksesin e njerëzve në shuma të mjaftueshme të të ardhurave dhe aftësinë për t'i përdorur ato në mënyrë të pavarur, me qëllim plotësimin e nevojave bazë në moshë më të madhe.

Fusha 2: Gjendja shëndetësore

Tre treguesit e përdorur për fushën e shëndetit japin informacion për mirëqenien fizike dhe psikologjike.

Fusha 3: Aftësia

Treguesit e punësimit dhe arsimit në këtë fushë shohin aspekte të ndryshme të fuqizimit të personave të vjetër.

Fusha 4: Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm

Kjo fushë përdor të dhëna nga Gallup World View për të vlerësuar perceptimin e të moshuarve për lidhjen sociale, sigurinë, lirinë qytetare dhe aksesin në transportin publik - çështje të cilat të moshuarit i kanë veçuar si të rëndësishme.

REFERENCAT

- Bloom, D.E., D. Canning and J. Sevilla 2003. The demographic dividend: a new perspective on the economic consequences of population change. RAND Population Matters Program MR-1274, Santa Monica CA.EC (2013), Working together for Europe's young people. A call to action on youth unemployment. Brussels, EC.
- Bravo, J. (1999), Fiscal Implications of Ageing Societies Regarding Public and Private Pension Systems. *In Population Ageing: Challenges for Policies and Programmes in Developed and Developing Countries*, R. Cliquet and M. Nizamuddin, eds. New York: UNFPA.
- Creedy, J. (1998), *Pensions and Population Ageing: An Economic Analysis*. Cheltenham, Edward Elgar Publishing.
- de Jong-Gierveld, J. and H. van Solinge (1995), Ageing and its Consequences for the Socio-Medical System. Population Studies, No. 29. Strasbourg, France: Council of Europe Press.
- Eurostat (2015a), Healthy life year statistics.
http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Healthy_life_years_statistics. Accessed 03/10/2015.
- Eurostat (2015b), Population structure and ageing.
http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Population_structure_and_ageing - Accessed 15/08/2015
- Ferré, C., E. Galanxhi dhe O. Dhono (2015), *Profili i Popullsisë me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri*. Tirana, UNDP.
- Gjonca, A., A. Aassve dhe L. Mencarini 2008. Shqipëria: Tendencat dhe modele, përcaktuesit e përafërt dhe politikat e ndryshimit të lindshmërisë. *Studim Demografik* 19(11): 261-292.
- Grundy, E. (2001), *Living arrangements and the health of older persons in developed countries*. Centre for Population Studies, London School of Hygiene and Tropical Medicine.
- Holliday, R. (1999), Ageing in the 21st century. *The Lancet*, Vol. 354, Supplement No. 4.
- Landi Gushi, L., F. Cucllari, and M. Cini (2014), Retirement fund system reform in Albania: issues and challenges. *Knowledge Horizons – Economics*, Vol. 6, No. 1, pp. 34-38.
- INSTAT (2004), *Projeksione të Popullsisë për Shqipërinë 2001-2021*. INSTAT, Tirana.
- INSTAT (2014a), *Popullsia dhe dinamika e popullsisë në Shqipëri. Horizonte të reja demografike?* Tirana, INSTAT.
- INSTAT (2014b), *Projeksione të popullsisë për Shqipërinë dhe qarqet e saj, 2011-2031*. Tirana, INSTAT.
- INSTAT (2014e), *Migracioni në Shqipëri*. Tirana, INSTAT.
- Kinsella, K. and Y.J. Gist (1995), *Older Workers, Retirement, and Pensions: A Comparative International Chartbook*. Washington, D. C.: United States Bureau of the Census (IPC/95-2RP).
- Lesthaeghe, R. 2010. The Unfolding Story of the Second Demographic Transition. *Population and Development Review* 36(2): 211-251.
- Lesthaeghe, R., L. Neidert and J. Surkyn (2007), Household Formation and the "Second Demographic Transition" in Europe and the US: Insights from Middle Range Models.
- Morgan, D.L., L. Tonya, L. Schuster and E.W. Butler (1991), Role reversals in the exchange of social support. *Journal of Gerontology*, Vol. 46, No. 5.
- Saad, P.M. (2001), *Support transfers between elderly parents and adult children in two Brazilian settings* (CD-ROM). Paper presented at the Twenty-fourth IUSSP General Population Conference, Salvador de Bahia, Brazil, 18-24 August 2001. Paris, IUSSP.
- Taeuber, C.M. (1992), Sixty-Five Plus in America. *Current Population Reports, Special Studies*, pp. 23-178. Washington, DC.: United States Bureau of the Census.

- United Nations (2002), *Political declaration and Madrid international plan of action*. Second World Assembly on Ageing, Madrid, Spain, 8-12 April 2002. New York, United Nations.
- United Nations (2009), *World Population Ageing 2009*. New York, Department of Economic and Social Affairs Population Division.
- Van de Kaa, D.J. 1987. Europe's Second Demographic Transition. *Population Bulletin*, 42(1), Population Reference Bureau, Washington (D.C.).
- Ylli, A. (2010), Shëndeti dhe kushtet sociale të të moshuarve në Shqipëri: të dhënat bazë nga një anketë kombëtare. *Public Health Reviews*, Vol. 32, No. 2, pp. 549-560.



